



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.186

26 dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 020 datë 24.11.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për hapjen e zyrës lokale gjermane për bashkëpunimin për zhvillim në Shqipëri”.....	9181
Ligj nr.10 021 datë 24.11.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes dhe protokollit bashkëlidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave”	9183
Ligj nr.10 022, datë 24.11.2008	Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar.....	9188
Akti normativ nr.7, datë 15.12.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar	9189
Vendim i KM nr.1617, datë 17.12.2008	Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr.589, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore”, të ndryshuar	9199
Vendim i GJK nr.25, datë 5.12.2008	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr.9399, datë 12.5.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	9199
Vendim i GJK nr.26, datë 15.12.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.581, datë 24.12.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.51, datë 17.3.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.1666, datë 15.12.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën	9210

Vendim i GJK
nr.27, datë 15.12.2008

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.4859, datë 22.7.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.767, datë 21.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2007-1022 (1019), datë 7.9.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën..... 9216

Vendim i GJK
nr.28, datë 16.12.2008

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1096, datë 31.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.180, datë 29.9.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr.1412, datë 26.12.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese 9217

LIGJ
Nr.10 020, datë 24.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR HAPJEN E ZYRËS LOKALE GJERMANE PËR BASHKËPUNIMIN
PËR ZHVILLIM NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për hapjen e zyrës lokale gjermane për bashkëpunimin për zhvillim në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5971, datë 12.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË
PËR HAPJEN E NJË ZYRE LOKALE TË BASHKËPUNIMIT GJERMAN PËR ZHVILLIM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

në zbatim të marrëveshjes së datës 21 tetor 1988 ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik, si dhe duke iu referuar pikës 4 të shënimeve mbi protokollin e konsultimeve ndërqeveritare të datës 23 prill 2008 për përgatitjen e bisedimeve ndërqeveritare të vitit 2008,
u morën vesh si vijon.

Neni 1

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, me qëllimin e mbështetjes së bashkëpunimit dypalësh ndërmjet dy vendeve, merren vesh

për hapjen e një zyre lokale të bashkëpunimit dypalësh gjerman në Tiranë (më poshtë e quajtur “zyrë”). Kjo zyrë mund të shfrytëzohet nga të gjitha organizatat zbatuese gjermane, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në Republikën e Shqipërisë me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe duke u marrë vesh me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Zyrës mund t’i jepen detyrat e mëposhtme:

1. Mbështetja për projektet në të gjitha aspektet e zbatimit të tyre.
2. Kryerja e detyrave më të gjera specifike dhe administrative në lidhje me zbatimin e projekteve, me të cilat merren organizatat e përmendura zbatuese me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.
3. Kryerja e detyrave, të cilat nuk kanë të bëjnë me ndonjë projekt të përcaktuar, por me specifikat e vendit.
4. Përfaqësimi i organizatave zbatuese në vend.

Neni 3

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë jep kontributet e mëposhtme:

Ajo:

1. merr përsipër të gjitha shpenzimet për investimet në zyrë dhe për funksionimin e saj;
2. merr përsipër shpenzimet për specialistët e dërguar me qëndrim afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe për punonjësit vendas që punësohen nga zyra.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep kontributet e mëposhtme:

Ai:

1. i çliron livrimet e materialeve dhe të automjeteve për zyrën nga licencat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga tatimet e tjera publike, si dhe nga pagesat për magazinim dhe garanton që materialet të zhdoganohen pa vonesë. Çlirimet e përmendura vlejnë me kërkesë të zyrës edhe për materialet e siguruar në Republikën e Shqipërisë;
2. i mbështet kërkesat e zyrës për:
 - pajisje me lidhje telekomunikimi, duke përfshirë radiondërlidhje dhe lidhje me satelit;
 - lejet e punës dhe të qëndrimit të specialistëve të dërguar, si dhe për lejet e punës të punonjësve vendas të zyrës;
3. u garanton specialistëve të dërguar të organizatave zbatuese dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët bëjnë pjesë të ekonomisë familjare, të gjitha të drejtat në përputhje me marrëveshjen e lartpërmendur të datës 21 tetor 1988;
4. e çliron zyrën nga taksat dhe tatimet publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Materialet e livruara për zyrën, duke përfshirë automjetet, mbeten pronë e organizatave zbatuese gjermane. Në çastin e shpërndarjes së zyrës, ato do të kalojnë në pronë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Emërimi i organizatave zbatuese:

1. Qeveria e Republikës Federale jep kontributet e saj nëpërmjet organizatave zbatuese të përmendura në nenin 1.
2. Bashkëbiseduesi shqiptar për organizatat zbatuese është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Kjo marrëveshje vlen për një afat trevjeçar dhe do të zgjatet çdo herë për dy vjet, në qoftë se ajo nuk anulohet me shkrim nga një palë kontraktuese gjashtë muaj para mbarimit të afatit aktual të vlefshmërisë.

Neni 8

Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988.

Neni 9

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë 23 tetor 2008 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

LIGJ

Nr.10 021, datë 24.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES DHE PROTOKOLLIT BASHKËLIDHUR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR
TË UDHËTARËVE DHE TË MALLRAVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja dhe protokoli bashkëlidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5972, datë 12.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE
PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE**

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli Federal Zviceran, që më poshtë do të quhen Palë Kontraktuese, me dëshirën për të lehtësuar transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave mes dy vendeve, si dhe kalimin tranzit përmes territoreve të tyre, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Objekti

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje gjejnë zbatim për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, origjina e të cilave ose destinacioni i itinerarit të transportit ndodhet në territorin e shtetit të njëres nga palët kontraktuese, me anë të mjeteve të transportit të regjistruara në territorin e shtetit të palës tjetër Kontraktuese.

Neni 2

Përkufizime

1. Termi “transportues” nënkupton një person fizik ose juridik me banim në Zvicër ose në Shqipëri, i cili autorizohet në bazë të ligjeve në fuqi në vendet përkatëse që të kryejë transport rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.

2. Termi “mjet” nënkupton një mjet rrugor, me shtytje mekanike dhe, nëse ka, rimorkio ose gjysmërimorkio, i cili është projektuar për transportin e:

- a) mbi nëntë udhëtarëve të ulur, përfshirë drejtuesin e mjetit; ose
- b) mallrave.

3. Termi “autorizim” nënkupton çdo licencë, koncesion ose leje që kërkohet nga legjislacioni në fuqi në shtetin e secilës nga Palët Kontraktuese.

Neni 3

Transporti i udhëtarëve

1. Transporti i rastit i udhëtarëve në kushtet e mëposhtme përjashtohet nga autorizimi:

transporti i personave të njëjtë me të njëjtin mjet transporti, gjatë gjithë udhëtimit, pikat e origjinës dhe destinacionit të të cilit gjenden në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese, ku mjeti është i regjistruar, dhe gjatë udhëtimit ose në ndalesa jashtë vendit në fjalë udhëtarët nuk hipin apo nuk zbresin nga mjeti i transportit (udhëtime me dyer të mbyllura), ose

transporti i një grupi njerëzish nga një pikë në vendin ku mjeti është i regjistruar, në një pikë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, me kusht që mjeti të largohet nga territori i shtetit të Palës së dytë Kontraktuese pa udhëtarë, ose,

transporti i një grupi njerëzish nga një pikë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese në një pikë në vendin ku mjeti është i regjistruar, me kusht që shërbimi të paraprihet nga një udhëtim në kthim pa udhëtarë dhe që udhëtarët:

- të jenë të grupuar në bazë të kontratave për transportin, të cilat lidhen përpara mbërritjes së tyre në vendin ku janë marrë, ose

- të jenë sjellë më parë nga i njëjti transportues, në kushtet që përmenden në germën “b” të këtij neni, në vendin ku janë marrë sërisht dhe janë transportuar jashtë këtij vendi, ose

- të kenë pasur ftesë për të udhëtuar në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe shpenzimet e transportit të mbulohen nga pritësi. Udhëtarët formojnë një grup homogjen, i cili nuk formohet vetëm për qëllimin e udhëtimit,

udhëtimet tranzit përmes territorit të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Transporti i udhëtarëve që plotëson kushtet e mëposhtme, përjashtohet nga autorizimi:

- Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim, tranzit, përmes ose drejtpërsëdrejti, në territorin e

Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, dhe

- udhëtimet pa ngarkesë të mjeteve, të cilat përdoren lidhur me shërbimet vajtje-ardhje.

Shërbimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kryhen sipas një dokumenti kontrolli.

Për lloje të tjera transporti, përveç atyre që përmenden në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, autorizimet janë të detyrueshme në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit të Palëve Kontraktuese. Autorizimet jepen në bazë të parimit të reciprocitetit.

Neni 4

Transporti i mallrave

Një transportues i një Pale Kontraktuese ka të drejtën të importojë përkohësisht një mjet transporti bosh ose me ngarkesë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, me qëllim që të kryejë operacione transporti, të cilat nuk u nënshtrohen lejeve si më poshtë:

a) ndërmjet një pike në territorin e shtetit të një Palë Kontraktuese dhe një pike në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, ose

b) kur niset nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese në drejtim të një vendi të tretë, kur vjen nga një vend i tretë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, ose

c) tranzit përmes territorit të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5

Zbatimi i legjislacionit kombëtar

Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen nga kjo Marrëveshje, transportuesit dhe drejtuesit e mjeteve të një Palë Kontraktuese, të cilët udhëtojnë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, janë të detyruar të respektojnë dispozitat ligjore dhe rregullat e kësaj të fundit, të cilat do të zbatohen për ta në mënyrë jodiskriminuese.

Neni 6

Ndalimi i transportit të brendshëm

Transporti i brendshëm i udhëtarëve dhe mallrave është i ndaluar. Komisioni i përbashkët, që përmendet në nenin 10, mund të përfshijë përjashtime nga ky rregull.

Neni 7

Shkeljet

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese kontrollojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga ana e transportuesve.

2. Autoritetet e Palës Kontraktuese ku mjeti është i regjistruar, në rast se transportuesit dhe drejtuesit e saj të mjeteve të transportit, ndërsa ndodhen në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, shkelin rregullat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe ligjet dhe rregullat e qarkullimit dhe transportit që janë në fuqi në atë territor, marrin masat e mëposhtme nëse kërkohet nga autoritetet kompetente të Palës së fundit Kontraktuese:

a) paralajmërim;

b) pezullim i përkohshëm, i pjesshëm ose i plotë i lejes së transportit në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese ku ka ndodhur shkelja.

3. Autoriteti kompetent njofton autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me masat që janë marrë.

4. Secila nga Palët Kontraktuese respekton dënimet që mund të jepen nga gjykatat ose autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit, për shkeljen që ka ndodhur në territorin e saj.

Neni 8

Autoritetet kompetente

Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me autoritetet që janë përgjegjëse për

zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto autoritete komunikojnë drejtpërsëdrejti.

Neni 9

Ekzekutimi dhe zbatimi

Një protokoll në lidhje me mënyrat dhe mjetet e zbatimit të Marrëveshjes në fjalë përfundohet njëkohësisht me këtë Marrëveshje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 10

Komiteti i përbashkët

1. Palët Kontraktuese krijojnë një komitet të përbashkët, i cili do të rregullojë të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin dhe përdorimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Komiteti i përbashkët është kompetent për modifikimin ose përfundimin e protokollit që përmendet në nenin 9.

3. Komiteti i përbashkët mbledhet me kërkesën e secilës nga Palët Kontraktuese; ai do të mbledhet në mënyrë të alternuar në territorin e shtetit të secilës nga Palët Kontraktuese.

Neni 11

Shtirja e Marrëveshjes në Principatën e Lihtenshteinit

Sipas një kërke formale të Principatës së Lihtenshteinit, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje shtrihen te ky vend për aq kohë sa mbetet në fuqi traktati për doganat që ka ajo me Zvicrën.

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e vlefshmërisë

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas shkëmbimit të notave diplomatike lidhur me kryrjen e të gjitha procedurave përkatëse kombëtare. Marrëveshja hyn në fuqi ditën kur bëhet njoftimi i fundit për të.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, lidhur në Tiranë, më 9 maj 1984, shfuqizohet.

3. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohore; ajo mund të përfundohet nga secila nga Palët Kontraktuese në fund të vitit kalendarik, duke bërë njoftim me shkrim për përfundimin e saj të paktën gjashtë muaj përpara.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, të cilët autorizohen për këtë nga qeveritë e tyre përkatëse, e nënshkruan këtë Marrëveshje.

Bërë në Bernë, më 30 shtator 2008 në dy tekste origjinale, në gjuhët shqip, frëngjisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet kanë të njëjtën vlefshmëri.

Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë përparësi versionin në gjuhën angleze.

PROTOKOLLI

PËR MARRËVESHJEN PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN

Në përputhje me nenin 9 të Marrëveshjes, Palët Kontraktuese kanë rënë dakord si më poshtë:

1. Transporti i udhëtarëve (neni 3)

Transportet sipas nenit 3, paragrafët 1 dhe 2, shoqërohen me një dokument udhëtimi, si dhe një listë të udhëtarëve.

Kërkesat për marrjen e autorizimeve lidhur me transporte të tjera të udhëtarëve, të cilat nuk i plotësojnë kushtet që përmenden në nenin 3, paragrafët 1 dhe 2 (për shembull, linjat e rregullta), i paraqiten autoritetit kompetent të vendit të regjistrimit të mjetit, i cili do t'ia transmetojë kërkesat autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

Në kërkesat e tyre, transportuesit njoftojnë për oraret, tarifat, itinerarin dhe gjithë informacionin tjetër që kërkohej nga autoritetet kompetente. Procedura për dhënien e autorizimit dhe të gjitha çështjet e tjera përkatëse rregullohen bashkërisht, në bazë të parimit të reciprocitetit, nga ana e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

Autoriteti kompetent që ka lëshuar autorizimin informon autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, duke i dërguar një kopje të dokumentit të lëshuar.

Autorizimet mbahen në mjet dhe i paraqiten autoriteteve të kontrollit, sipas kërkesës. Për shërbimet e rregullta, numri i autorizimeve të lëshuara bazohet te numri i mjeteve, të cilat kryejnë transport në këtë itinerar.

Gjatë një tranziti me mjet pa ngarkesë, transportuesi justifikon se po e kalon me mjet pa ngarkesë territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Me paraqitjen e justifikimit, mjetet të cilat dërgohen për të zëvendësuar autobuzët që janë dëmtuar ose janë prishur, përjashtohen nga marrja e autorizimit për hyrje me mjet pa ngarkesë.

2. Transporti i mallrave (neni 4)

Kur udhëtimet kryhen duke përdorur një kombinim të mjeteve çift të transportit, të cilët përbëhen nga elemente të kombësive të ndryshme, rregullat e Marrëveshjes zbatohen për të gjithë kombinimin vetëm nëse njësia tërheqëse është e regjistruar në shtetin e njërit nga Palët Kontraktuese.

3. Zbatimi i legjislacionit kombëtar (neni 5)

Palët Kontraktuese pranojnë se neni 5 i Marrëveshjes gjen zbatim veçanërisht te legjislacioni për transportin rrugor dhe qarkullimin rrugor, peshat dhe përmasat e mjeteve të transportit, kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit të ekuipazhit të mjetit të transportit, kohës së ngarjes së automjetit, si dhe te legjislacioni për taksat rrugore.

Autoritetet kompetente (neni 8)

Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes janë:

Për Shqipërinë:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Sheshi “Skënderbej”, nr.5, Tiranë-Shqipëri

Për Zvicrën:

Ministria Federale e Mjedisit, Transportit, Energjisë dhe Komunikacionit

Zyra Federale e Transportit

CH-3003 Berne

Peshat dhe përmasat e mjeteve të transportit

Përsa u përket peshave dhe përmasave të mjeteve të transportit, secila nga Palët Kontraktuese bie dakord që mjetet e transportit të regjistruara në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese nuk do t’u nënshtrohen kushteve më kufizuese sesa mjetet e transportit të regjistruara në shtetin e saj.

Procedurat e mëposhtme zbatohen:

Për Shqipërinë:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, rruga “Sami Frashëri”, Tiranë, e cila do të lëshojë autorizim të veçantë për mjetet e transportit që e kalojnë peshën dhe përmasat e lejuara, të cilat parashikohen në legjislacionin kombëtar.

Për Zvicrën:

Zyra Federale e Rrugëve, CH-3003, Bernë, e cila do të lëshojë autorizim të veçantë vetëm për transportin e mallrave të pandashme dhe nëse kushtet e rrugës e lejojnë transportin.

Në çdo rast, nuk tejkalohet pesha e garantuar që lejon prodhuesi.

Procedura doganore

Lënda djegëse dhe benzina në serbatorët normalë të mjeteve, që lejohen përkohësisht, lejohen pa doganë.

Pjesët e këmbimit të sjella nga jashtë për riparimin e një mjeti të caktuar transporti, që tashmë është importuar përkohësisht, lejohen në bazë të lejimit të përkohshëm pa doganë dhe pa ndalimin ose kufizimin e importimit. Pjesët e zëvendësuara u nënshtrohen taksave doganore, rieksporthen ose

asgjësohen nën kontrollin e doganës.

Bërë në Bernë më 30 shtator 2008, në dy tekste origjinale, në gjuhët shqip, frëngjisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet kanë të njëjtën vlefshmëri.

Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ka përparësi versioni në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr. 10 022, datë 24.11.2008

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8537, DATË 18.10.1999 “PËR
BARRËT SIGURUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25
Regjistri i barrëve siguroese

Regjistri i barrëve siguroese krijohet dhe ofron shërbimin e regjistrimit të barrëve siguroese, të pretendimeve dhe të të drejtave, që lindin nga ky ligj ose nga çdo ligj tjetër, i cili kërkon ose lejon regjistrimin në këtë regjistrë.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është përgjegjëse për veprimtarinë e regjistrimit të barrëve siguroese.

Në rastet kur ky shërbim i delegohet një personi juridik privat, në formën e koncesionit, sipas ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, ofruesi i shërbimit i propozon Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës emërimin e kryeregjistruesit të regjistrimit të barrëve siguroese dhe të një ose disa zëvendësve të tij.

Në të gjitha rastet, regjistri i barrëve siguroese është pronë publike.”.

Neni 2

Në fund të nenit 27 “Përgjegjësia e Këshillit të Ministrave” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur ky shërbim ofrohet nga një subjekt juridik privat, ofruesi i shërbimit është përgjegjës për humbjen e shkaktuar, si rezultat i gabimeve ose mosfunksionimit të sistemit të regjistrimit. Kufijtë e përgjegjësisë dhe mënyra se si do të garantohet mbulimi i humbjeve përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet palëve.

Shteti nuk ka detyrim të mbulojë efektet (humbjet), në rast të deklarimit të barrëve false.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5973, datë 12.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**AKTI NORMATIV
Nr.7, datë 15.12.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9836, DATË 26.11.2007 “PËR BUXHETIN E
SHTETIT TË VITIT 2008”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti i Shtetit, për vitin 2008, është:

Të ardhurat	298 220 milionë lekë;
Shpenzimet	354 762 milionë lekë;
Deficiti	56 542 milionë lekë.

Buxheti i Shtetit përbëhet nga fondi i konsoliduar, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe buxheti i sigurimeve shëndetësore.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

A. Fondi i konsoliduar, për vitin 2008, është:

Të ardhurat	250 061 milionë lekë;
Shpenzimet	306 603 milionë lekë;
Deficiti	56 542 milionë lekë.

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A.1. Buxheti qendror:

Të ardhurat	236 979 milionë lekë;
Shpenzimet	293 521 milionë lekë;

A.2. Buxheti i pushtetit vendor:

Të ardhurat 29 146 milionë lekë;

Nga të cilat:

- Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror 16 064 milionë lekë;
- Shpenzimet 29 146 milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

B. Buxheti i sigurimeve shoqërore, për vitin 2008, është:

B.1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

Të ardhurat gjithsej 63 560 milionë lekë;
- Nga kontributet 42 750 milionë lekë;
- Nga transferimet nga Buxheti i shtetit 20 810 milionë lekë;
Shpenzimet 63 560 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategori specifike të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2008, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

B.2. Skema e sigurimit suplementar:

Të ardhurat, gjithsej 3 153 milionë lekë;
- Nga kontributet 186 milionë lekë;
- Nga transferimet nga Buxheti i Shtetit 2 967 milionë lekë;
Shpenzimet 3 153 milionë lekë.”.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Të ardhurat e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

- Grantet 2 507 milionë lekë;
- Të ardhurat tatimore 209 711 milionë lekë;
- Të ardhurat jotatimore 24 761 milionë lekë;
- Të ardhurat e buxhetit vendor 13 082 milionë lekë.”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit është 56 542 milionë lekë, i cili parashikohet të financohet deri në masën 2 000 milionë lekë, nga të ardhurat e privatizimit dhe diferenca me huamarrje të brendshme e të jashtme.

Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja

e brendshme për financimin e deficitit të buxhetit nuk mund të jetë më e madhe se 19 847 milionë lekë. Këshilli i Ministrave, për kompensimin e diferencave, siguron burime suplementare ose merr masa për shkurtrimin e shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimet strategjike përdoren në vitin e arkëtimit ose në vitin pasardhës, në masën 50 për qind, për uljen e huamarrjes, dhe 50 për qind, për investime publike, të rëndësishme, që përbëjnë përparësi strategjike dhe buxhetore. Kufiri i huamarrjes së brendshme dhe të jashtme ulet në masën e përdorimit të të ardhurave, të arkëtuara nga privatizimi i ARMO-sh.a. Në rast se përdoret pjesa e këtyre të ardhurave të realizuara për investime, Këshilli i Ministrave autorizohet të rrisë, në të njëjtën masë, kufirin e shpenzimeve dhe deficitin e Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji.”.

Neni 6

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Shpenzimet e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime korrente	209 763 milionë lekë;
- Shpenzime kapitale	91 140 milionë lekë;
- Rezerva e Këshillit të Ministrave	2 400 milionë lekë;
- Fondi i kontigjencës	3 300 milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion është përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij akti normativ. Për institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave, kufiri i shpenzimeve dhe numri i punonjësve do të jenë sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij akti normativ. Gjendja e mjeteve monetare, që parashikohet të rezultojë në fund të vitit buxhetor, në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose i tejkalimit të të ardhurave, të transferohet në llogarinë e shpronësimeve për interes publik, por jo më shumë se 0.3 për qind e PBB-së. KESH, sh.a.-së, t’i transferohet, në formën e huasë, fondi 2 600 milionë lekë, ndërsa OST, sh.a.-së, t’i transferohet, në formën e huasë, fondi prej 150 milionë lekë për investime.”.

Neni 7

Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

Një pjesë e fondit të kontigjencës, 2 000 milionë lekë, të përdoret për rritjen e pagave dhe të pagesës sociale, me miratimin e Këshillit të Ministrave. Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, prej 2 400 milionë lekësh, përdoret për raste të paparashikuara në buxhet. Pjesa tjetër e fondit të kontigjencës 1 300 milionë lekë, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Në nenin 12 shifra “1 180 milionë lekë” bëhet “1 020 milionë lekë”.

Neni 9

Neni 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 16

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve përfituese, për vitin 2008, është 73 660 milionë lekë, i ndarë, si më poshtë vijon:

1. Kufiri i rritjes së borxhit të shtetit nga huamarrja e brendshme dhe e jashtme, për financimin e deficitit buxhetor është 54 542 milionë lekë, ku huamarrja e brendshme nuk mund të jetë më shumë se 19 847 milionë lekë. Kufiri maksimal i huamarrjes së brendshme neto ulet në varësi të disbursimeve nga huatë e jashtme, duke respektuar kufirin e rritjes së borxhit të shtetit, për financimin e deficitit buxhetor.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfëtuese, është 10 618 milionë lekë, përfshirë edhe 200 milionë lekë garanci, për fondin e garantimit të kredive të eksportit.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i mbulimit të diferencave nga rivlerësimi i valutave, është 8 500 milionë lekë.”.

Neni 10

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tab. 1

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	Presidenca	155.000	250.000	0	0	250.000	405.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	155.000	250.000	0	0	250.000	405.000
2	Kuvendi	856.000	164.000	0	0	164.000	1.020.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	856.000	164.000	0	0	164.000	1.020.000
3	Keshilli Ministrave	316.970	24.000	0	0	24.000	340.970
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	316.970	24.000	0	0	24.000	340.970
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	843.000	506.882	0	500.000	1.006.882	1.849.882
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	409.500	52.212	0	0	52.212	461.712
04320	Mbeshtetje per Energjine	1.000	9.000	0	0	9.000	10.000
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	0	214.000	0	0	214.000	214.000
04440	Mbesht. Miniera e Nd/je Publike	51.500	35.800	0	0	35.800	87.300
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	156.639	177.400	0	450.000	627.400	784.039
04160	Mbeshtetje per Mbiq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	224.361	18.470	0	50.000	68.470	292.831
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit	3.271.126	1.107.484	0	1.093.179	2.200.663	5.471.789
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	212.500	0	0	0	0	212.500
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1.178.850	93.967	0	127.500	221.467	1.400.317
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	743.500	739.750	0	765.000	1.504.750	2.248.250
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	907.676	203.305	0	200.679	403.984	1.311.660
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujgesor	226.000	70.462	0	0	70.462	296.462
05470	Menaxhimi gendrushem i tokes bujqesore	2.600	0	0	0	0	2.600
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	4.351.203	30.348.698	0	37.095.887	67.444.585	71.795.788
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	298.206	18.500	0	0	18.500	316.706
04520	Rrjeti i rrugeve nacionale	1.398.025	25.743.198	0	34.037.896	59.781.094	61.179.119
04530	Menaxhimi i Transportit	19.650	11.000	0	0	11.000	30.650
04540	Portet	57.906	196.113	0	370.000	566.113	624.019
04550	Hekurudhat	464.497	210.767	0	0	210.767	675.264
04560	Aviacioni Civil	57.431	16.625	0	0	16.625	74.056
06370	Ujesjelles Kanalizime	1.519.182	3.652.895	0	2.404.991	6.057.886	7.577.068
06180	Strehimi dhe Urbanistika	401.514	323.000	0	283.000	606.000	1.007.514
06220	Sherbimet publike	134.792	176.600	0	0	176.600	311.392
10	Ministria e Financave	5.250.000	556.062	0	0	556.062	5.806.062
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	157.800	32.593	0	0	32.593	190.393
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	374.500	28.000	0	0	28.000	402.500
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	119.000	0	0	0	0	119.000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	1.680.000	130.560	0	0	130.560	1.810.560
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	1.393.750	354.473	0	0	354.473	1.748.223
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	42.250	10.436	0	0	10.436	52.686
10270	Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore	1.429.000	0	0	0	0	1.429.000
01180	Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike	53.700	0	0	0	0	53.700
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	29.983.150	4.490.089	771.200	789.285	6.050.574	36.033.724
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	842.527	103.850	0	0	103.850	946.377
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	17.499.703	2.605.100	0	760.085	3.365.185	20.864.888
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	3.722.446	761.000	0	20.600	781.600	4.504.046
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	1.963.919	399.969	0	5.600	405.569	2.369.488
09450	Arsimi Universitar	5.784.555	423.170	771.200	3.000	1.197.370	6.981.925
09770	Fonde per Shkencen	170.000	197.000	0	0	197.000	367.000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	1.410.122	642.165	0	0	642.165	2.052.287
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	146.930	6.000	0	0	6.000	152.930
08220	Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	306.327	306.965	0	0	306.965	613.292
08230	Arti dhe Kultura	512.180	252.800	0	0	252.800	764.980

08140	Zhvillimi i Sportit	208.443	60.000	0	0	60.000	268.443
08250	Programe specifike kulturore	142.700	0	0	0	0	142.700
04760	Zhvillimi i Turizmit	93.542	16.400	0	0	16.400	109.942
13	Ministria e Shendetesise	19.638.000	2.285.840	46.000	645.000	2.976.840	22.614.840
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	210.000	278.993	0	0	278.993	488.993
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7.228.000	428.694	20.000	355.000	803.694	8.031.694
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytësor	11.414.000	1.549.282	20.000	290.000	1.859.282	13.273.282
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	786.000	28.871	6.000	0	34.871	820.871

Tab. 1

BUXHETI I VITIT 2008 SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj			
14	Ministria e Drejtesise	4.396.800	460.776	0	291.556		752.332	5.149.132
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	236.700	159.900	0	89.873		249.773	486.473
01120	Publikimet Zyrtare	36.200	9.800	0	15.683		25.483	61.683
01130	Mjekesia Lijore	44.600	6.350	0	0		6.350	50.950
03440	Sistemi i Burgjeve	2.772.000	265.526	0	36.000		301.526	3.073.526
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	162.100	2.500	0	0		2.500	164.600
01160	Sherbimet per cheshtjet e biresimeve	11.300	500	0	0		500	11.800
01170	Sherbimi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	455.900	12.700	0	150.000		162.700	618.600
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	678.000	3.500	0	0		3.500	681.500
15	Ministria e Puneve te Jashtme	1.640.000	262.780	0	0		262.780	1.902.780
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	44.350	5.800	0	0		5.800	50.150
01120	Perfaqesite Diplomatike	1.355.650	245.800	0	0		245.800	1.601.450
01130	Promovimi i imazhit te vlerave te vendit	88.000	7.180	0	0		7.180	95.180
01140	Integrimi europian dhe euro-atlantik	152.000	4.000	0	0		4.000	156.000
16	Ministria e Brendshme	13.072.000	1.205.851	59.649	650.000		1.915.500	14.987.500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	558.970	271.895	19.649	250.000		541.544	1.100.514
09420	Arsimi dhe Shkenca (Akademia)	181.522	4.800	0	0		4.800	186.322
03140	Policia e Shtetit	9.709.324	337.400	40.000	350.000		727.400	10.436.724
03150	Garda e Republikes	1.073.944	33.340	0	0		33.340	1.107.284
01160	Prefekturat dhe FunkSIONET e Deleguara te P. Vendor	498.538	2.500	0	0		2.500	501.038
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	356.081	537.116	0	0		537.116	893.197
10910	Emergjencat Civile	693.621	18.800	0	50.000		68.800	762.421
17	Ministria e Mbrojtjes	13.777.200	4.236.000	100.000	0		4.336.000	18.113.200
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1.256.300	246.400	0	0		246.400	1.502.700
02120	Forcat e Luftimit	3.564.400	1.600.000	0	0		1.600.000	5.164.400
09430	Arsimi Ushtarak	1.130.500	111.800	0	0		111.800	1.242.300
07340	Mbeshtetje Shendetesore	523.400	16.700	0	0		16.700	540.100
02150	Mbeshtetje e Luftimit	1.558.300	390.450	0	0		390.450	1.948.750
02160	Mbeshtetje e Pergendruar	3.196.700	1.821.650	100.000	0		1.921.650	5.118.350
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	1.923.000	0	0	0		0	1.923.000
02280	Bashkepunimi Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)	624.600	49.000	0	0		49.000	673.600
18	Sherbimi Informativ Shtetror	1.086.080	17.721	0	0		17.721	1.103.801
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1.086.080	17.721	0	0		17.721	1.103.801
19	Drejtoria e Radio Televizionit	478.000	20.000	0	0		20.000	498.000
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti	314.000	0	0	0		0	314.000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	80.000	20.000	0	0		20.000	100.000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	44.000	0	0	0		0	44.000
08340	Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise	40.000	0	0	0		0	40.000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	125.000	12.000	0	17.850		29.850	154.850
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	125.000	12.000	0	17.850		29.850	154.850
22	Akademia e Shkences	92.600	2.000	0	0		2.000	94.600
01510	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	92.600	2.000	0	0		2.000	94.600
24	Kontrolli Larte i Shtetit	248.000	20.000	0	0		20.000	268.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	248.000	20.000	0	0		20.000	268.000
25	Ministria e Punes, Cheshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	40.049.100	246.970	0	170.000		416.970	40.466.070
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	157.630	12.000	0	0		12.000	169.630
10220	Sigurimi Shoqeror	20.430.600	0	0	0		0	20.430.600
10430	Mbrojtja Sociale	17.791.100	116.500	0	170.000		286.500	18.077.600
10550	Tregu i Punes	1.509.500	118.470	0	0		118.470	1.627.970

04170	Inspektimi ne Pune	148.890	0	0	0	0	148.890
10460	Shanset e Barabarta	11.380	0	0	0	0	11.380
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1.094.000	201.977	47.900	292.900	542.777	1.636.777
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74.000	5.000	0	0	5.000	79.000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	87.900	18.625	0	115.300	133.925	221.825
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	67.100	36.600	0	12.700	49.300	116.400
05640	Administrimi i Ujrave	21.000	0	0	0	0	21.000
04260	Administrimi i Pyjeve	844.000	141.752	47.900	164.900	354.552	1.198.552
28	Prokuroria e Pergjithshme	988.608	22.781	0	0	22.781	1.011.389
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	988.608	22.781	0	0	22.781	1.011.389

Tab. 1

BUXHETI I VITIT 2008 SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj		
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	1.244.490	60.000	0	0	60.000	1.304.490
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1.244.490	60.000	0	0	60.000	1.304.490
30	Gjykata Kushtetuese	90.000	6.000	0	0	6.000	96.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	90.000	6.000	0	0	6.000	96.000
31	Ajensia Telegrafike Shqiptare	97.800	4.000	0	0	4.000	101.800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	97.800	4.000	0	0	4.000	101.800
40	Partite Politike	200.000	0	0	0	0	200.000
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	192.000	0	0	0	0	192.000
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	5.000	0	0	0	0	5.000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	3.000	0	0	0	0	3.000
50	Instituti Statistikes	192.500	17.524	0	0	17.524	210.024
01310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	192.500	17.524	0	0	17.524	210.024
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	13.000	6.672	0	0	6.672	19.672
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	13.000	6.672	0	0	6.672	19.672
55	Shkolla e Magjistratures	48.591	1.360	0	0	1.360	49.951
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	48.591	1.360	0	0	1.360	49.951
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	595.000	0	380.000	975.000	975.000
06210	Programe Zhvillimi	0	595.000	0	380.000	975.000	975.000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	126.988	2.000	0	0	2.000	128.988
08210	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	126.988	2.000	0	0	2.000	128.988
59	Instituti i Integritimit te Perndjekurve Politik	26.000	2.000	0	0	2.000	28.000
01110	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	26.000	2.000	0	0	2.000	28.000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	68.000	4.000	0	0	4.000	72.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	68.000	4.000	0	0	4.000	72.000
66	Avokati i Popullit	80.000	11.600	0	0	11.600	91.600
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	80.000	11.600	0	0	11.600	91.600
67	Komisioni i Sherbimit Civil	43.000	1.600	0	0	1.600	44.600
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	43.000	1.600	0	0	1.600	44.600
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	86.000	1.000	0	0	1.000	87.000
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	86.000	1.000	0	0	1.000	87.000
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0
76	Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	83.000	5.000	0	0	5.000	88.000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	83.000	5.000	0	0	5.000	88.000
77	Autoriteti i Konkurences	52.000	4.000	0	0	4.000	56.000
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	52.000	4.000	0	0	4.000	56.000
78	Ministria e Integritimit	130.300	11.918	0	0	11.918	142.218
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	43.420	10.318	0	0	10.318	53.738
01140	Drejtesia dhe Tregu i Brendshem	26.057	800	0	0	800	26.857
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integritimit	60.823	800	0	0	800	61.623
82	Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	12.000	987	0	0	987	12.987
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12.000	987	0	0	987	12.987
86	Avokati i Prokurimeve	22.000	6.600	0	0	6.600	28.600
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	22.000	6.600	0	0	6.600	28.600
87	Institucione te tjera Qeveritare	224.000	213.187	0	0	213.187	437.187
01320	Sherbime Qeveritare	81.000	205.187	0	0	205.187	286.187
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	42.000	0	0	0	0	42.000
01140	Sherbime per shogerite e informacionit	38.000	0	0	0	0	38.000
01150	Sherbime te tjera	63.000	8.000	0	0	8.000	71.000

88	Mbeshtetje per Shogerine Civile	0	0	0	0	0	0
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	0	0	0	0	0
TOTALI		145.961.628	48.038.524	1.024.749	41.925.657	90.988.930	236.950.558

Tab. 1.1

<i>ne 000/leke</i>			
Kodmin	Institucionet e Pavarura	Nr. Punonjesve	Buxheti Total
1	Presidenca	80	405.000
2	Kuvendi	440	1.020.000
24	Kontrolli i Larte i Shtetit	160	268.000
28	Prokuroria e Pergjithshme	807	1.011.389
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1.230	1.304.490
30	Gjykata Kushtetuese	50	96.000
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	45	19.672
55	Shkolla e Magjistratures	22	49.951
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	41	72.000
66	Avokati i Popullit	50	91.600
67	Komisioni i Sherbimit Civil	28	44.600
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	87.000
76	Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	41	88.000
77	Autoriteti i Konkurences	35	56.000
86	Avokati i Prokurimeve	15	28.600

Tab. 2

Buxheti i vitit 2008 per Pushtetin Gjyqesor

ne 000/leke

Nr	Emertimi	Korente	Investime	Totali
1	Gjykata e Larte	173.000	6.400	179.400
2	Gjykatat e Apelit	243.370	2.700	246.070
3	Gjykatat e Faktit	806.140	49.900	856.040
4	Z.A.B.GJ.	21.980	1.000	22.980
	Shuma	1.244.490	60.000	1.304.490

TREGUESIT FISKALE TE BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2008
(FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2008)

ne milion leke (in million of leks)

Nr.	E M E R T I M I	Akt Normativ 2008	Ne % te PBB	Diferenca absolute	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	298.220	27.7%	-5.563	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	2.507	0.2%	-2.163	Grants
	Nga kjo:Mbeshtetje buxhetore(Gerdec)	0	0.0%	0	From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	270.952	25.1%	-5.400	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	209.711	19.5%	0	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	106.903	9.9%	2.000	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	18.420	1.7%	0	Profit Tax
3	Akcizat	35.493	3.3%	-2.000	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	23.272	2.2%	0	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	16.212	1.5%	0	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	9.411	0.9%	0	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	13.082	1.2%	-2.500	Local Taxes
1	Taksa Lokale	7.987	0.7%	-1.500	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	2.136	0.2%	-1.000	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2.959	0.3%	0	Small Business Tax
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	48.159	4.5%	-2.900	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	42.936	4.0%	-2.900	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	5.223	0.5%	0	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	24.761	2.3%	2.000	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	5.500	0.5%	0	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	10.800	1.0%	800	Income of budgetary institutions
3	Gerdec			-480	
4	Dividenti	5.243	0.5%	200	Divident
5	Te tjera	3.218	0.3%	1.480	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	354.760	32.9%	-5.447	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	254.841	23.6%	-2.568	Current Expenditures
1	Personeli	67.060	6.2%	-899	Personnel expenditures
	Paga	56.451	5.2%	-646	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	10.609	1.0%	-252	Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash				Of which; Contingency for new policies
2	Interesat	31.575	2.9%	-1.005	Interest
	Te Brendshme	28.400	2.6%	-300	Domestic
	Te Huaja	3.175	0.3%	-705	Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	28.079	2.6%	-564	Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financim i Huaj	225		0	From which: Foreign Financing
4	Subvencionet	2.566	0.2%	600	Subsidies
5	Shpenzime per Sig.Shoq e Shendet	77.873	7.2%	-800	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	66.713	6.2%	-800	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	11.160	1.0%	0	Health insurance
6	Shpenzime per Buxhetin Lokal	29.146	2.7%	-2.500	Local Budget expenditure
	Buxheti lokal (Granti)	16.064	1.5%	0	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	13.082	1.2%	-2.500	Local Budget (Own revenues)
7	Shpenzime te tjera	18.042	1.7%	2.600	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	900	0.1%	-100	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	14.742	1.4%	2.700	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1.000	0.1%	0	Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjiine elektrike	1.400	0.1%	0	Compensation for electricity
8	Kompensim ne vlere i pronareve	500	0.0%	0	Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	5.700	0.5%	-4.200	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	2.400	0.2%	0	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjenca per Politika Pagash dhe Pensionesh	2.000	0.2%	0	Contingency for Wages and Pensions Increase
	Fondi Kontigjenca per Investime Publike	0	0.0%	0	Contingency for Investments
	Fond Kontigjenca	1.300	0.1%	-4.200	Contingency
	Nga e cila: Kompensim Gerdec	0	0.0%	-1.500	
III.	Gerdec	480	0.0%	0	Gerdec revenues
IV	Shpenzime Kapitale	91.139	8.5%	-3.280	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	49.063	4.6%	215	Domestic financing
	Nga e cila: Transferta Kapitale per OST	150	0.0%	-2.850	Of which: Contingency
	Financimi Huaj	41.926	3.9%	-3.645	Foreign financing

V	Net Lending KESH	2.600	0.2%	4.600	KESH-net lending
	DEFICITI	-56.540	-5.2%	-116	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	56.541	5.2%	117	Financing (Cash)
	Brendshem	21.847	2.0%	748	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	2.000	0.2%	-2.140	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	19.847	1.8%	2.888	Domestic borrowing
	Te tjera		0.0%	0	Other
	I Huaj	34.694	3.2%	-632	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	39.644	3.7%	-1.482	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkesh*		0.0%	0	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-4.950	-0.5%	850	Repayments
	Mbeshetje buxhetore				Budget Support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB) 2008	1.078.000			

VENDIM
Nr.1617, datë 17.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.589, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.589, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

a) Përmbajtja e numrit rendor 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Rafineria e Ballshit (KPTHN) të ruhet dhe të sigurohet nga Policia e Shtetit deri në përfundimin e procesit të privatizimit dhe dorëzimit të objektit nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

b) Pas numrit rendor 13 shtohet numri 14, me këtë përmbajtje:

“14. “Tipografia ushtarake” sh.a. person juridik, në varësi të Ministrisë së Brendshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.25, datë 5.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 2.10.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 Akti, që i përket:

Kërkues: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Klodian Rado, gjyqtar, dhe avokat Vangjel Kosta, me prokurë të posaçme.

Subjekte të interesuara:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë.

Konferenca Gjyqësore Kombëtare, përfaqësuar nga zëvendëskryetari i Këshillit Ekzekutiv, z.Albert Meçe.

Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.9399, datë 12.5.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 2; 6; 7; 81, pika 2, shkronja “a”; 131, shkronja “a”; 134, shkronja “f”; 145, pika 1, 3 dhe 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 49 e vijues i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuarit që kërkojnë pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e Kuvendit që kërkojnë rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare që e la zgjidhjen e çështjes në vlerësimin e gjykatës, si dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Që nga miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në vitin 1998 dhe deri në vitin 2005, organizimi dhe funksionimi i Konferencës Gjyqësore Kombëtare ka qenë i rregulluar nëpërmjet normave të brendshme të statutit të miratuar prej saj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.9399, datë 12.05.2005, ka parashikuar, nëpërmjet rregullimeve juridike, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Konferencës Gjyqësore Kombëtare. Sipas këtij ligji, Konferenca Gjyqësore Kombëtare e Shqipërisë është organi përfaqësues i gjyqtarëve të të gjitha niveleve të Republikës së Shqipërisë, në përbërje të të cilit përfshihen anëtarët e Gjykatës së Lartë për shkak të detyrës, kryetarët e gjykatave të shkallës së parë, kryetarët e gjykatave të apelit dhe një numër i caktuar gjyqtarësh, të zgjedhur nga konferencat gjyqësore rajonale. Në këtë ligj janë parashikuar kompetencat e Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe rregullat bazë për mënyrën e financimit, funksionimin dhe zgjedhjen e anëtarësisë e të organeve drejtuese të saj.

2. Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar që ligji nr.9399, datë 12.5.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare” të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Argumentet kryesore të kërkuarit janë përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Procedura për miratimin e këtij ligji, që rregullon organizimin dhe funksionimin e një institucioni të parashikuar nga Kushtetuta, është kryer në kundërshtim me nenin 81 pika 2 shkronja “a” të saj.

- Në referim të nenit 147 të Kushtetutës, kuptimi kushtetues i Konferencës Gjyqësore Kombëtare përcaktohet nga kompetenca e saj për të zgjedhur, nga tërësia e gjyqtarëve të të gjitha niveleve, përfaqësuesit e gjyqësorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

- Ligji vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe cenon drejtpërdrejt pavarësinë e gjyqësorit. Ky ligj favorizon pushtet të veçantë për persona të ndryshëm brenda pushtetit gjyqësor.

- Imponimi nga ligjvënësi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e trupës gjyqësore në ushtrimin e kompetencës kushtetuese për të zgjedhur përfaqësuesit e vet përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e pushtetit gjyqësor dhe cenim të pavarësisë së tij.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar argumentet në vijim:

- Kërkesa është paraqitur tej afatit procedural të përcaktuar nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

- Kërkuesi nuk legjitimohet të kërkojë antikushtetutshmërinë e ligjit, në këndvështrim të nenit 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës, sepse duke mos e argumentuar interesin në këtë gjykim, ai nuk përfshihet në grupin e subjekteve që parashikohen në shkronjat “a” deri në “ç” të nenit 134 pika 1 të Kushtetutës.

- Neni 147 i Kushtetutës nuk ka parashikuar Konferencën Gjyqësore Kombëtare si një institucion kushtetues, por Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe nuk ka kërkuar që organizimi dhe funksionimi i saj të bëhet me ligj.

- Kërkuesi nuk ka specifikuar dispozitën kushtetuese me të cilën është në kundërshtim formula e parashikuar në ligj për caktimin, për shkak të detyrës, të anëtarëve në Konferencën Gjyqësore Kombëtare. Fakti që nuk janë anëtarë të Konferencës Gjyqësore Kombëtare të gjithë gjyqtarët, nuk sjell antikushtetutshmëri të dispozitave ligjore.

- Nuk ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, për arsye se asnjë pushtet tjetër nuk ndërhyr te gjyqësori për të propozuar apo imponuar përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është shprehur për pranimin e kërkesës, duke i përqendruar parashtrimet e tij me shkrim drejtuar kësaj gjykate, në këto drejtime kryesore:

- Ligji ka krijuar një përplasje me frymën e Kushtetutës për misionin dhe qëllimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare. Ligji e ka devijuar elementin “kombëtar” nga dimensionin kushtetues, sepse nuk e ka referuar zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të tërësia e gjyqtarëve të të gjitha niveleve, por vetëm të një pjesë e tyre.

- Në kundërshtim me vizionin dhe frymën e Kushtetutës, ligji u jep disa gjyqtarëve të drejta dhe privilegie më shumë se të tjerëve. Nenet 3 dhe 4 të ligjit, për të zgjedhur 9 anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sanksionojnë një raport të diferencuar dhe një peshë të dalluar vote mes anëtarëve të Gjykatës së Lartë e kryetarëve të gjykatave, nga njëra anë dhe gjyqtarëve të dy niveleve, nga ana tjetër.

- Mënyra e aplikuar për zgjedhjen e anëtarëve të Konferencës Gjyqësore Kombëtare është në kundërshtim me frymën demokratike brenda organizmave social-politike dhe të parimit “një anëtar, një votë”.

- Ligji nuk ka realizuar një zgjidhje të mirë dhe efektive për organizimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

II

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson të nevojshme të analizojë paraprakisht legjitimitimin e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e ka argumentuar mungesën e legjitimitimit të kërkuesit në këtë gjykim kushtetues, për shkak të subjektit konkret që ai përfaqëson (*ratione personae*), për shkak të kalimit të afatit 3-vjeçar për të paraqitur kërkesën (*ratione temporis*), si dhe për shkak të mungesës së lidhjes ndërmjet interesit të tij të drejtpërdrejtë me thelbin e çështjes në gjykim (*ratione materiae*).

2. Në kuptim të rregullimit të parashikuar nga nenet 131 shkronja “a” dhe 134 pika 2 shkronja “f” të Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet për këtë çështje Gjykatës Kushtetuese. Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve është regjistruar si subjekt juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2160, datë 25.1.2008. Në nenin 1 të statutit të Shoqatës është parashikuar, si një ndër qëllimet kryesore të saj, “konsolidimi, forcimi dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor në tërësi”.

Kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve, e paraqitur nga kryetarja e saj, në kuptim të kompetencës që parashikohet në nenin 10 të statutit, përmban si argument parësor, që Gjykata e konsideron të përfshirë në sferën e qëllimit të kësaj Shoqate, pretendimin për cenim të parimit të

ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, të parimit të pavarësisë së gjyqësorit, që kanë të bëjnë me rolin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare si institucioni që zgjedh shumicën absolute të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Kërkesi legjitimohet *ratione temporis* pasi kërkesa është regjistruar brenda afatit të parashikuar në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ligji, objekt shqyrtimi, është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 14.6.2005. Vetë ligji, në nenin 12 të tij, përcakton se “ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Rezulton se ky afat 15-ditor është plotësuar në datën 29.6.2005. Sipas një vërtetimi me nr. extra, datë 4.7.2008 të lëshuar nga Dega e Shërbimeve të Filialit të Postës Shqiptare, Tiranë dhe të administruar në këtë gjykim kushtetues, rezulton se kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve, me “nr.7283 është pranuar në sportelin e Postës Qendër-Tiranë në datën 27.6.2008”.

Në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se kërkesat për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre”. Në nenin 1 paragrafi 2 të ligjit është sanksionuar rregullisht se “për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Në këtë kontekst, neni 149 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se “afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit”.

4. Pa i hyrë paraprakisht analizës mbi pajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me Kushtetutën, Gjykata vlerëson se kërkesi legjitimohet *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e ligjit, në këndvështrim të nenit 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës.

Në kuptim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, çështjen e legjitimitetit të kërkesit Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që përcakton iniciimin e procesit kushtetues. Për gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në dispozitën e sipërcituar, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe pretendimit për shkelje kushtetuese në çështjen e ngritur. Shoqatat (organizatat e tjera) janë parashikuar në nenin 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007 dhe nr.17, datë 25.7.2008).

Për të vlerësuar legjitimitetin e subjektit, të cilit i kërkohet të justifikojë interesin e tij në lidhje me çështjen, Gjykata duhet të përcaktojë të drejtën kushtetuese ose ligjore të subjektit, i cili pretendon se i është cenuar për shkak të antikushtetutshmërisë së normës konkrete të kundërshtuar para saj.

Neni 81 pika 2 shkronja “a” i Kushtetutës, që kërkesi pretendon të jetë shkelur nga ligji objekt shqyrtimi, është normë kushtetuese me karakter procedural. Në jurisprudencën kushtetuese është argumentuar se subjektet e parashikuara në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës nuk legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike duke paraqitur si argument ekzistencën e veseve formale, në qoftë se vetë norma nuk ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t’i mbrojë para Gjykatës. Në çështjen në shqyrtim, kërkesi pretendon se ligji i kundërshtuar ka cenuar si në formë, ashtu edhe në përmbajtje standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, në veçanti, me pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Në jurisprudencën e kësaj Gjykate është theksuar se “deklarimet e neneve 6 dhe 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës shprehen në funksion të garantimit të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese. Sipas nenit 6, organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohet me ligjet e tyre përkatëse...”, ndërsa në nenin 81 pika 2 shkronja “a” theksohet, ndër të tjera, se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit... Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj i tyre, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila u jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet organeve dhe institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 3.5.2007).

Pavarësisht se në formë, neni 81 pika 2 shkronja “a” i Kushtetutës, është normë me natyrë procedurale, në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga

Kushtetuta. Kjo dispozitë kushtetuese është edhe në funksion të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe pretendimi për cenimin e kësaj prerogative procedurale, i ngritur pikërisht nga një subjekt, i cili në veprimtarinë ligjore ka një mision të tillë, e bën të pranishëm ekzistencën e interesit për çështjen në shqyrtim. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve legjitimohet *ratione materiae* të kërkojë kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën.

III

1. Një ndër pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për të argumentuar antikushtetutshmërinë në tërësi të ligjit, objekt shqyrtimi, është mosrespektimi nga ligjvënësi i kërkesave të nenit 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës, sipas të cilit ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit,

Sipas kërkuesit, Konferenca Gjyqësore Kombëtare është një institucion i parashikuar si i tillë për herë të parë nga Kushtetuta dhe i pajisur me kompetencën për të zgjedhur nëntë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga tërësia e gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Ndërsa sipas pretendimit të subjekteve të interesuara, Konferenca Gjyqësore Kombëtare nuk përfshihet në shtrirjen e termit kushtetues “*institucion*” dhe, për rrjedhojë, ligji që rregullon veprimtarinë e saj nuk kërkon miratimin me një shumicë të cilësuar të votave të anëtarëve të Kuvendit.

Për t’u dhënë zgjidhje të drejtë pretendimeve të subjekteve në këtë proces kushtetues, Gjykata e çmon të nevojshme të bëjë interpretimin në nenin 81 pika 2 shkronja “a” të termit “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*”, si dhe të vendit që zë Konferenca Gjyqësore Kombëtare, në kuptim të nenit 147 të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se neni 81 pika 2 shkronja “a” dhe veçanërisht termi “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*” duhet të interpretohet në lidhje dhe me nenin 6 të Kushtetutës, që përdor termin “*organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë*”.

Në kuptimin doktrinar, por edhe në atë të jurisprudencës kushtetuese, institucionet konsiderohen si tërësi strukturash dhe mekanizmash juridikë që rregullojnë sjellje brenda një komuniteti shoqëror. Termi “*institucion*” përdoret si ndaj zakoneve dhe sjelljeve të rëndësishme për një shoqëri, ashtu dhe ndaj organizimeve formale të qeverisjes dhe të shërbimeve publike. Si mekanizma të rendit dhe të bashkëpunimit shoqëror, institucionet shfaqen qoftë si organizma (organe) *formalë*, objektivisht realë, ashtu edhe si tërësi rregullash që përcaktojnë një situatë juridike të dhënë. Për rrjedhojë, edhe termi “*organ*”, në kuptimin e përgjithshëm të tij, konceptohet si instrument me funksion të caktuar, por dhe si element që, i lidhur me strukturën e një institucioni, siguron funksionimin normal të tij (shih Gerard Cornu: *Vocabulaire juridique*, Editions PUF, Paris 2004).

Gjykata vlerëson se rregullimi kushtetues që imponon organizimin dhe funksionimin me ligj të organeve të parashikuara në Kushtetutë (neni 6), duhet parë i lidhur ngushtë me respektimin e procedurës së votimit, në kuptim të nenit 81 pika 2 shkronja “a”. Kjo dispozitë kushtetuese ka parashikuar shumicën e cilësuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit si mënyrë votimi për ligjet, mbi bazën e të cilëve organizohen dhe funksionojnë institucionet e parashikuara nga Kushtetuta, në dallim nga votimi me shumicë të thjeshtë që kërkohet për ligjet e tjera.

Në këtë mënyrë, me anë të ligjeve që kërkojnë një konsensus më të gjerë, Kushtetuta nuk ka disiplinuar vetëm bazat e funksionimit të organizimit të institucioneve/organeve kushtetuese, të cilat janë vendosur në krye të organizimit shtetëror dhe që ndikojnë në formën e shtetit e të qeverisjes, por edhe të atyre institucioneve që mund të parashikohen prej saj dhe që nuk konsiderohen si përcaktuese për strukturën kushtetuese të shtetit.

Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese e kanë bërë dallimin ndërmjet *institucioneve kushtetuese* nga njëra anë, dhe *institucioneve me rëndësi kushtetuese* apo të *parashikuara nga Kushtetuta*, nga ana tjetër. Institucionet kushtetuese konsiderohen si elemente të domosdoshme dhe të pandashme të shtetit, sepse mungesa e njërit do të sillte ndalimin e veprimtarisë së plotë shtetërore dhe zëvendësimi i tyre me institucione të tjera nuk mund të mos shkaktoje ndryshim në mënyrë rrënjësore të formës së shtetit. Struktura bazë e këtyre institucioneve përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë e të plotë nga Kushtetuta. Megjithatë, Gjykata çmon të nevojshme të theksojë se ndërsa *institucionet kushtetuese* janë përcaktuar në Kushtetutë, jo të gjitha *institucionet e parashikuara në Kushtetutë* konsiderohen si “*institucione/organe kushtetuese*”. Pra, dallimi mes *institucioneve kushtetuese* dhe *institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*, pavarësisht nga fakti i përmendjes shprehimisht prej saj, qëndron se të parat janë organe të nevojshme e të pashmangshme në përcaktimin e formës së shtetit e të qeverisjes, ndërsa të dytat kontribuojnë për përcaktimin e rregullimit demokratik kushtetues

dhe si organe ndihmëse nuk janë thelbësore për strukturën kushtetuese të shtetit.

Nga kjo analizë, Gjykata nxjerr konkluzionin se Kushtetuta, në nenin 81 pika 2 shkronja “a”, me termin “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*” ka pasur parasysh një shtrirje të gjerë të tij, duke përfshirë në të njëjtin rregullim procedural miratimin e ligjeve si për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese, ashtu edhe për institucionet e parashikuara prej saj. Në këtë rregullim kushtetues nuk përfshihen vetëm institucionet kushtetuese, sipas kuptimit të dhënë më lart, por edhe ato institucione të parashikuara nga Kushtetuta, të cilat, nëpërmjet saj, kanë fituar si personalitetin juridik, ashtu edhe kompetencën kushtetuese. Gjykata e çmon të nevojshme të sqarojë se jo çdo institucion që përmendet në Kushtetutë duhet të përfshihet domosdoshmërisht në procedurën e miratimit të ligjit sipas nenit 81 pika 2 shkronja “a”. Ky qëndrim është rrjedhojë e faktit të ekzistencës së dallimit thelbësor ndërmjet *institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta* dhe institucioneve që vetëm sa përmenden prej saj. Kuptimi i termit “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*” lidhet me vullnetin e kushtetutbërësit për t’i dhënë institucionit personalitet juridik, me qëllim përmbushjen prej tij të kompetencës specifike kushtetuese. Në Kushtetutë përmenden edhe institucione të tjera, të cilat nuk pajisen prej saj me kompetencë kushtetuese. Për rrjedhojë, institucione të tilla si: “*drejtuesit e institucioneve shtetërore*” (neni 80), “*Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit*” (neni 92, shkronja “f”), “*Kryetari i Akademisë së Shkencave*”, *rektorët e universiteteve*” (neni 92, shkronja “g”), “*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm*” (neni 169, pika 3) etj. nuk mund të njësohen dhe as të përfshihen në termin “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*”, në kuptim të nenit 81 pika 2 shkronja “a”.

I ndryshëm është pozicioni që i është dhënë Konferencës Gjyqësore Kombëtare nga Kushtetuta. Nëpërmjet nenit 147 të Kushtetutës, ajo ka fituar personalitet juridik dhe është njohur si i vetmi organizëm vendimmarrës, i pajisur me kompetencën kushtetuese për të zgjedhur 9 gjyqtarë në funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Mbi këtë analizë, Gjykata nxjerr përfundimin se Konferenca Gjyqësore Kombëtare, si një nga ato institucione që parashikohet drejtpërdrejt nga Kushtetuta, nuk përjashtohet nga rregullimi procedural i nenit 81 pika 2 shkronja “a”.

IV

1. Kërkuar pretendon se ligji, objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe në veçanti me parimin e pavarësisë së gjyqësorit, në kuptim të neneve 6, 81, pika 2 shkronja “a”, 145 pika 1, 3 dhe 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve. Ky parim do të thotë që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe me një balancë ndërmjet tyre. “Çdo institucion i një pushteti gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, si dhe nga raportet e fuqive të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007 dhe nr.11, datë 2.4.2008*).

Jurisprudenca kushtetuese, në respekt të zbatimit të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe të parimit të shtetit të së drejtës, ka theksuar se pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar si *pavarësi thelbësore* (tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit) dhe si *pavarësi strukturore*, që kërkon parashikimin në Kushtetutë të institucionit që realizon emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve. Si pjesë të *pavarësisë strukturore* konsiderohen njëkohësisht edhe *pavarësia organizative dhe financiare*.

Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik, por nuk përbën një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Në këtë

kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Mbrojtja e një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008*). Nga ana tjetër, pavarësia e gjyqësorit nuk mund të kuptohet pa pavarësinë e gjyqtarit brenda vetë strukturës së gjyqësorit, nëpërmjet së cilës sigurohet që asnjë gjyqtar të mos mund të ndërhyjë në veprimtarinë dhe bindjen e një gjyqtari tjetër. Mbi këto standarde kushtetuese, që kanë gjetur konfirmimin e tyre në jurisprudencën kushtetuese, është e orientuar Gjykata për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim.

2. Për t'i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit, Gjykatës i nevojitet fillimisht të analizojë vendin që i është caktuar Konferencës Gjyqësore Kombëtare në Kushtetutë. Konferenca Gjyqësore Kombëtare përmendet për herë të parë në nenin 147, pika 1 të Kushtetutës si një organizëm vendimmarrës. Rregullimi i parashikuar në dispozitën kushtetuese të sipërcituar, sipas së cilës 9 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, vendos një raport të drejtë ndërmjet autoritetit me të cilin vishen këta gjyqtarë ndaj të gjithë gjyqtarëve të rretheve gjyqësore dhe të apeleve, nga njëra anë, dhe të drejtës së çdo gjyqtari, si anëtar i Konferencës Gjyqësore Kombëtare për të marrë pjesë në zgjedhjen e 60% të anëtarësisë së këtij institucioni me rëndësi kushtetuese, nga ana tjetër. Pra, funksioni parësor i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, i parashikuar nga vetë Kushtetuta, konsiston në zgjedhjen, nga e gjithë trupa e gjyqësorit, të 9 përfaqësuesve të tij, në organin që vendos për emërimin e transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (si një organizëm me rëndësi kushtetuese, i përbërë në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, në ushtrimin e funksionit të tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij organi me korpusin gjyqësor), është ngritur për të garantuar funksionin vetëqeverisës të gjyqësorit. Frymën e korporatës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kushtetutbërësi e ka përfshirë me synimin për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 22.5.2006, nr.35, datë 10.10.2007, nr.17, datë 25.7.2008*).

Një zgjidhje e tillë është në përputhje të plotë edhe me dokumentet ndërkombëtare të gjithëpranuara, në të cilat është konfirmuar qëndrimi se për “*çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari, kërkohet ndërhyrja e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që marrin pjesë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit*”. Gjyqtarët që janë anëtarë të organit të pavarur “*duhet të zgjidhen nga kolegët e tyre, për arsye se pavarësia e nevojshme e këtij organi përjashton zgjedhjen ose emërimin e anëtarëve të tij nga një autoritet politik që i përket ekzekutivit ose legjislaturës*. Pa insistuar në ndonjë sistem votimi të veçantë, metoda për të zgjedhur përfaqësuesit e gjyqtarëve në këtë organ duhet të garantojë përfaqësimin më të gjerë të gjyqtarëve” (*shih Kartën Europiane mbi Statutin e Gjyqtarëve dhe Memorandumin shpjegues për Kartën Europiane mbi Statutin e Gjyqtarëve - Këshilli i Europës - 1998*).

Në dritën e interpretimit sistematik dhe teleologjik, Gjykata konstaton se vendosja e Konferencës Gjyqësore Kombëtare në pjesën e nëntë të Kushtetutës, të titulluar “*Gjykata*”, ku është sanksionuar dhe kompetenca e saj, synon krijimin e një organizmi të gjyqtarëve, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe garancive kushtetuese që i vishen pushtetit gjyqësor. Përderisa Këshilli i Lartë i Drejtësisë është kompozuar si një organizëm me strukturë të përzier dhe me një shumicë të cilësuar nga radhët e gjyqësorit, Kushtetuta i ka dhënë Konferencës Gjyqësore Kombëtare një pozitë të rëndësishme kushtetuese dhe e ka pajisur atë me një rol përcaktues në funksion të forcimit dhe të mbrojtjes së pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

3. Pas shqyrtimit tërësor të përmbajtjes së ligjit nr.9399, datë 12.5.2005 “*Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare*”, Gjykata tërheq konkluzionin se ligjvënësi nuk është kufizuar vetëm në referimin te norma kushtetuese që parashikon zgjedhjen e 9 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në nenin 1 të ligjit, Konferenca Gjyqësore Kombëtare është konceptuar si organi përfaqësues i gjyqtarëve të të gjitha niveleve të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që ky ligj ka parashikuar dhe një organizëm tjetër, Konferencën Gjyqësore Rajonale, e cila nga ana e saj zgjedh

Konferencën Gjyqësore Kombëtare.

Me anë të dispozitave të këtij ligji, është normuar juridikisht organizimi i strukturave të brendshme të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, si dhe është përcaktuar sistemi i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përmes votimit të tërthortë në dy nivele, ku niveli i parë, i përbërë nga shumica absolute e të gjithë gjyqtarëve, të organizuar në konferencat gjyqësore rajonale, zgjedh nivelin e dytë, Konferencën Gjyqësore Kombëtare, që është praktikisht përzgjedhësja e kandidaturave fituese. Sipas ligjit, përbërja e Konferencës Gjyqësore Kombëtare është kufizuar vetëm te gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe kryetarët e gjykatave të apelit, të cilët janë anëtarë të saj, për shkak të detyrës që kryejnë, si dhe tek anëtarët e tjerë që zgjidhen nga konferencat gjyqësore rajonale.

Për çështjen në shqyrtim para saj, Gjykata e çmon të domosdoshme të theksojë se nuk mund të konsiderojë si çështje të juridiksionit kushtetues pretendimet e palëve për përshtatshmërinë apo efektivitetin e mënyrës së zgjedhur nga ligjvënësi për të rregulluar një marrëdhënie juridiko-shoqërore, por, nuk mund të mënjanojë nga gjykimi kushtetues ato rregullime, të cilat vijnë në kundërshtim me standardet kushtetuese.

Sipas nenit 1 të ligjit, objekt shqyrtimi, “Konferenca Gjyqësore Kombëtare është organi përfaqësues i gjyqtarëve të të gjitha niveleve të Republikës së Shqipërisë.” Me përcaktimin që i është bërë Konferencës Gjyqësore Kombëtare, si organ përfaqësues i gjyqtarëve, por jo si një organizëm që përfshin tërësinë e gjithë gjyqtarëve, ligjvënësi ka bërë një rregullim të ndryshëm nga sa parashikon neni 147 i Kushtetutës. Gjykata vëren se Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit, për t’i dhënë Konferencës Gjyqësore Kombëtare fizionominë e një organi përfaqësues të gjyqësorit dhe, aq më pak, që zgjedhjen e saj ta realizojë një tjetër organizëm siç është Konferenca Gjyqësore Rajonale.

Mbështetur në përmbajtjen e dispozitave kushtetuese, si edhe në natyrën specifike me të cilën janë veshur disa organe të pushtetit shtetëror, zbatimi i rregullave të përgjithshme të demokracisë përfaqësuese është pranuar gjerësisht si mjeti më i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për ngritjen dhe funksionimin e organeve me natyrë politike. Jo vetëm për nga mënyra e formulimit të nenit 147 të Kushtetutës, por edhe për arsye të funksionit të rëndësishëm që luan Këshilli i Lartë i Drejtësisë për pushtetin gjyqësor, në referim edhe të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, Gjykata konkludon se qëllimi i kushtetutbërësit nuk ka qenë konstituimi i Konferencës Gjyqësore Kombëtare si një organ përfaqësues, por si organizëm i të gjithë gjyqtarëve që organizohet dhe vetëqeveriset nga vetë gjyqësori. Parashikimi drejtpërdrejt nga Kushtetuta i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, duke i veshur kësaj statusin e institucionit me kompetencë të rëndësishme kushtetuese, ka për qëllim garantimin e pavarësisë së gjykatës si institucion për t’i ngritur pengesë jo vetëm autoriteteve të tjera shtetërore (në radhë të parë, ekzekutivit dhe ligjvënësit), por edhe cilitdo personi a funksionari brenda vetë gjyqësorit.

4. Nenet 3 dhe 4 të ligjit, objekt shqyrtimi, parashikojnë se anëtarët e Gjykatës së Lartë, kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe kryetarët e gjykatave të apelit janë anëtarë, për shkak të detyrës, të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe ata nuk i nënshtrohen procesit të votimit dhe përzgjedhjes nga masa e të gjithë gjyqtarëve, ndërsa Kryetari i Gjykatës së Lartë është Kryetari i Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe kryeson Këshillin Ekzekutiv të saj.

Gjykata vlerëson se përcaktimi dhe pozicioni *ipso jure* i pjesës drejtuese të gjyqësorit në Konferencën Gjyqësore Kombëtare, sipas ligjit, krijon një standard të dyfishtë dhe i vendos gjyqtarët në pozita jo të njëjta, përsa i përket ushtrimit të së drejtës dhe të detyrës kushtetuese për zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Ky rregullim i ligjit, përveçse nuk është në përputhje me konceptin e Kushtetutës, krijon hapësirë për ndikim të papërshtatshëm nga funksionarë të ndryshëm brenda Konferencës Gjyqësore dhe, për rrjedhojë, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se tërësia e gjyqtarëve të të gjitha niveleve si një organizëm vetërregullues duhet të ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe të standardeve kushtetuese, në respekt të pavarësisë së jashtme dhe të brendshme të gjyqësorit e të gjyqtarëve, me qëllimin që zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të garantojë ushtrimin e funksionit kushtetues të këtij fundit në mbrojtje të pavarësisë dhe të vetadministrimit të gjyqësorit.

Përderisa ndodhemi përpara dispozitave ligjore që nuk mbështeten në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata thekson se është prekur, veç të tjerash, edhe parimi i shtetit të së drejtës, i shprehur me përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore. Ky është një qëndrim i

konsoliduar i mbajtur nga Gjykata, në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji” (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 9.11.2005). Në vijim të shqyrtimit të çështjes, në kuptim dhe të nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata vlerëson se neni 147 pika 1, që ka sanksionuar kompetencën e Konferencës Gjyqësore Kombëtare për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga gjyqtarët e të gjitha niveleve, mbetet një dispozitë e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Mbi bazën e analizës së bërë, Gjykata arrin në përfundimin se ligji, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar procedurën e parashikuar nga neni 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës, si edhe parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “a” dhe 134 pika 2 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash, për mosrespektim të procedurës së parashikuar nga neni 81 pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës dhe, njëzëri, për shkelje të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve e të pavarësisë së gjyqësorit, në kuptim të neneve 6 e 147 të Kushtetutës,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.9399, datë 12.5.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

Jemi të të njëjtit mendim me shumicën lidhur me faktin se mënyra e përzgjedhjes së anëtarësisë së Konferencës Gjyqësore Kombëtare është në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës dhe përbën cenim të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Megjithatë kemi mendim të ndryshëm sa i takon njërit prej shkaqeve, mbi të cilat shumica ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

Konkretisht, kërkuesi pretendon, mes të tjerash, se nuk janë respektuar kërkesat për formën dhe procedurën e miratimit të ligjeve të parashikuara nga neni 81/2 shkronja “a” të Kushtetutës, pasi ligji për Konferencën Gjyqësore Kombëtare duhej të ishte miratuar me shumicë prej 3/5, duke qenë se objekti i këtij ligji ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së një organi të parashikuar nga Kushtetuta. Shumica e ka pranuar si të bazuar këtë argument, duke theksuar, mes të tjerave, se institucionet e parashikuara nga Kushtetuta janë organe ndihmëse, jothelbësore për strukturën e shtetit, por që kontribuojnë për përcaktimin e rregullimit demokratik të shtetit. Në këtë kuptim, sipas mendimit të shumicës, Konferenca Gjyqësore Kombëtare ka një funksion të veçantë që lidhet me zgjedhjen e 9 gjyqtarëve si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe për këtë qëllim ligji për rregullimin e veprimtarisë së këtij organi duhet miratuar me shumicë të cilësuar.

Nuk pajtohem me argumentin e shumicës, për këto arsye:

1. Së pari, nuk jemi të qëndrimit se gjatë kontrollit kushtetues që ushtron Gjykata Kushtetuese me qëllim verifikimin e respektimit të elementeve formale dhe materiale të parashikuara nga Kushtetuta për miratimin e një ligji, kjo Gjykatë mund të marrë përsipër përmendjen në mënyrë

shterruese të organeve që do të konsiderohen “të parashikuara nga Kushtetuta” në kuptim të nenit 6 të saj. Ne përkrahim qëndrimin se është në vlerësimin ekskluziv të ligjvënësit, si i vetmi organ që ka si tagër të vetën plotësimin e kuadrit ligjor sipas formës dhe përmbajtjes që i takon çdo organi ose institucioni që do të ushtrojë veprimtarinë e vet në një shtet të së drejtës, të përcaktojë se cilat organe do të kenë mënyrë organizimi, funksione e kompetenca të tilla vendimmarrëse që do të kushtëzojnë miratimin e ligjeve me shumicë të cilësuar. Nëse ligjvënësi e ka parë të arsyeshme ta rregullojë me ligj të zakonshëm veprimtarinë e një organizmi, i cili ka për detyrë vetëm zgjedhjen e 9 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë kjo është shprehja e vullnetit të tij që nuk duhet të vihet në pikëpyetje gjatë kontrollit kushtetues. Në një situatë të ndryshme, nëse ligjvënësi nuk do të kishte vlerësuar si të nevojshëm rregullimin me ligj, Konferenca Gjyqësore Kombëtare do ta kishte ushtruar këtë funksion të saj në mungesë të një ligji, me një rregullim tjetër, që mund të ishte p.sh. statuti ose një rregullore e thjeshtë, mjafton që ajo të zgjidhte 9 anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas nenit 147/1 të Kushtetutës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta detyrojë ligjvënësin që ta rregullojë domosdoshmërisht me ligj veprimtarinë e Konferencës Gjyqësore Kombëtare e për më tepër me ligj organik, pasi është në çmimin e vetë ligjvënësit të veprojë apo jo dhe në çdo rast të zgjedhë edhe procedurën përkatëse.

2. Së dyti, pavarësisht faktit se Konferenca Gjyqësore Kombëtare zgjedh 9 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vetëm kjo nuk mjafton për t’i dhënë asaj statusin juridik të një institucioni në kuptim të nenit 81/2 të Kushtetutës apo të organit të parashikuar nga Kushtetuta në kuptim të nenit 6 të saj. Kushtetuta në parashikimin e institucioneve apo të organeve ka pasur si qëllim mbrojtjen e pavarësisë ose të autonomisë së tyre gjatë procesit të vendimmarrjes për shkak të rëndësisë së veçantë që ata kanë për organizimin shtetëror dhe funksionimin normal të shtetit të së drejtës. Gjithashtu, vetë Kushtetuta ka parashikuar se për disa organe dhe institucione të krijuara nga vetë ajo duhet të miratohen ligje organike, si akte që parashikojnë dispozitat përkatëse për funksionimin në përputhje me parimet kushtetuese të institucioneve që parashikohen nga Kushtetuta dhe që i nënshtrohen një procedure hartimi dhe miratimi të ndryshme nga ajo që parashikohet për miratimin e ligjeve të zakonshme.

Ligji organik është një instrument juridik që shërben për mbrojtjen e një ose disa sferave të caktuara nëpërmjet miratimit të kuadrit të tyre ligjor me një procedurë më komplekse se ajo që përdoret për ligjet e zakonshme. Si ligjet organike (ose kushtetuese), ashtu edhe ligjet e thjeshta janë norma që burojnë nga Kushtetuta dhe të dyja këto akte janë produkt i organit ligjvënës. Ajo që i bën ato të dallueshme nga njëra-tjetra është objekti dhe fuqia juridike e secilit. Objekti i një ligji organik është i qenësishëm për organizimin shtetëror, pra ai merr përsipër të rregullojë një fushë ose çështje që ligjvënësi nuk dëshiron ta rregullojë me ligj të zakonshëm, pikërisht për t’i garantuar atij epërsinë ndaj akteve të tjera (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007). Referimi i drejtpërdrejtë të Kushtetuta për krijimin e këtyre akteve, sipas një procedure të caktuar, u jep atyre fuqinë e veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit, duke kërkuar një mbështetje më të gjerë në Kuvend dhe garanci më të mëdha për mbrojtjen nga ndryshimet, dhe për rrjedhojë një qëndrueshmëri më të madhe.

Duke pasur parasysh sa më sipër, jemi të mendimit që vetëm fakti i përzgjedhjes së 9 gjyqtarëve nuk mund t’i japë Konferencës Gjyqësore Kombëtare funksionin e institucionit të parashikuar nga Kushtetuta, në kuptim të nenit 81/2 germa “a”. Për të fituar këtë status juridik, një organi ose institucioni i nevojitet parashikimi në Kushtetutë i elementeve kryesore që lidhen me organizimin dhe funksionimin e tij. Lind pyetja: çfarë roli dhe çfarë kompetence ka ky organ (Konferenca Gjyqësore Kombëtare), që duhet të konsiderohet si i parashikuar nga Kushtetuta me qëllim rregullimin e veprimtarisë së tij me ligj organik? Çfarë e bën Konferencën Gjyqësore Kombëtare të dallueshme nga Akademia e Shkencave (neni 92/g), Prefekti (neni 114), Këshilli i Sigurimit Kombëtar (neni 168), institucione të cilat parashikohen nga Kushtetuta? Këto organe, pavarësisht se përmenden në Kushtetutë, nga natyra e funksioneve dhe rolin që luajnë në funksionimin e shtetit nuk janë dhe nuk mund të konsiderohen të tilla që të diktojnë nevojën e rregullimit me ligj organik. I vetmi funksion që mund të rezultojë nga përmbajtja e nenit 147/1 është zgjedhja nga forumi i të gjithë gjyqtarëve i 9 prej tyre që do të bëjnë pjesë në një organ të parashikuar nga Kushtetuta siç është Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ky i fundit ushtron kompetenca dhe funksione të tilla që, për nga natyra dhe rëndësia e tyre, plotësojnë kushtet e nenit 81/2 dhe për këtë qëllim justifikojnë edhe nxjerrjen e ligjit organik për këtë qëllim, ndërsa Konferenca Gjyqësore Kombëtare, si një bashkësi e të

gjithë gjyqtarëve të vendit, nuk i përmbush kriteret e përmendura më lart për të pasur të njëjtin rregullim kushtetues, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Përmendja e Konferencës Gjyqësore Kombëtare në nenin 147/1 të Kushtetutës nuk është bërë për të garantuar pavarësinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por për të parashikuar mënyrën e formimit dhe përbërjes së tij. Shtrojmë pyetjen: Po nëse Kushtetuta do të kishte parashikuar që një ose më shumë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, do të zgjidheshin nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë ose nga Mbledhja e Përgjithshme e Avokatëve dhe Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë? Atëherë edhe këto forume do të duhej të rregulloheshin me një ligj organik? E kemi të vështirë të përgjigjemi pozitivisht, pasi një qëndrim i tillë do të krijonte probleme përkufizimi ose dallimi në thelb dhe në formë midis organeve kushtetuese dhe organeve të tjera, të cilat sipas qëndrimit të shumicës duhet të miratohen me 3/5. Nëse do të pranohet kështu, atëherë shtrohet pyetja se çfarë qëllimi ka në vetvete dispozita e nenit 81/2 që ka përcaktuar miratimin me 3/5 të organeve kushtetuese, nëse kjo shumicë do të përdorej edhe për organet e tjera që nuk hyjnë në këtë grup?

Përfundimisht, bazuar në argumentet e parashtruara më lart, jemi të mendimit se shumica nuk duhej ta kishte pranuar këtë argument si bazë për shfuqizimin e ligjit për Konferencën Gjyqësore Kombëtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vitore Tusha

VENDIM Nr.26, datë 15.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 13.3.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.4 Akti, që i përket:

KËRKUES: Sindikata e Pavarur e Transporteve të Shqipërisë, përfaqësuar nga avokatët Rustem Gjata dhe Gjergji Hysa, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drita Konomi, Alfred Konomi, Aida Hoxha, Aretushe Konomi, Arben Konomi, Viktor Konomi, Jorgo Konomi, Aneta Konomi, Melpomeni Konomi, Dhimitër Konomi, Harilla Konomi, Gjinovefa Konomi, Andrea Konomi, Lame Konomi, Astrit Konomi, Irini Konomi, Kleopatra Konomi, Anteo Konomi, në mungesë.

Fatos Konomi, përfaqësuar nga Arjan Konomi dhe av.Dashamir Kore, me prokurë.

Konfederata e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, në mungesë.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, dega Vlorë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.581, datë 24.12.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.51, datë 17.3.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.1666, datë 15.12.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 42, 131/f e 141 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuarit që kërkuar pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara që kërkojnë rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, me vendimin nr.59, datë 21.11.1994, ka njohur pronar trashëgimlënësin Dhimitër Konomi mbi një sipërfaqe trualli në bregdet prej 16 mijë m², duke i kthyer trashëgimtarëve të tij, kërkuarve Konomi, një sipërfaqe trualli prej 10 mijë m².

Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.1318, datë 21.5.1996, ka rrëzuar kërkesëpadinë e subjekteve të interesuara (Konomi), me të cilën kërkohej t'i bëheshin shtesa e ndryshime vendimit të lartpërmendur të Komisionit, në mënyrë që t'u kthehej atyre gjithë sipërfaqja e lënë nga trashëgimlënësi Dhimitër Konomi, përfshirë dhe truallin ku ndodhen godinat e ish-shtëpive të pushimit të punëtorëve.

Gjykata e Apelit Vlorë, në rigjykim, me vendimin nr.581, datë 24.12.2003, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave, duke u njohur e kthyer subjekteve të interesuara edhe disa sipërfaqe trojesh. Për trojet me sipërfaqe 2140 m² e 2060 m², mbi të cilat ndodhen përkatësisht godinat e shtëpisë së vjetër dhe të re të punëtorëve, gjykata e apelit vendosi kthimin e tyre, duke e kushtëzuar këtë kthim me zgjidhjen paraprake të problemit të pronësisë midis ish-pronarëve (kërkuarve) dhe pronarëve të rinj (sindikatave). Me kërkesën e subjekteve të interesuara (Konomi), gjykata e apelit, me vendimin nr.51, datë 17.3.2004, plotësoi dhe sqaroi vendimin e saj të mëparshëm, duke u kthyer në pronësi kërkuarve sipërfaqet e trojeve mbi të cilat ndodhen godinat e shtëpive të pushimit. Me këtë vendim plotësues është vendosur gjithashtu edhe kthimi subjekteve të interesuara, i godinave të shtëpive të pushimit të punonjësve, pa e kushtëzuar kthimin e tyre me zgjidhjen paraprake të mosmarrëveshjes së pronësisë me pronarët e rinj, Konfederatën e Sindikatave dhe Sindikatën e Pavarur të Transportit.

Me rekursin e shtruar nga disa prej palëve ndërgjyqëse, ndërmjet të cilave dhe kërkuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit (me gjithë plotësimet e bëra).

Kërkuar, duke pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar proces jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të tyre:

- Kërkesa e subjekteve të interesuara për plotësimin e vendimit nr.581, datë 24.12.2003 të gjykatës së apelit është paraqitur jashtë afatit 30-ditor që parashikon neni 313 i Kodit të Procedurës Civile dhe si rrjedhojë, gjykata e apelit nuk kishte tagër për ta marrë atë në shqyrtim.

- Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka thirrur kërkuar në shqyrtimin e kërkesës së bërë nga paditësit për plotësim dhe sqarim vendimi dhe gjykimi i kësaj çështjeje është bërë në mungesë të tij.

- Gjykata ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së kërkuarit, sepse e zhveshi nga pronësia mbi godinën e shtëpisë së re të pushimit, pa e vënë në pozitën procedurale të të paditurit.

- Vendimi nr.51, datë 17.3.2004 i Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka plotësuar vendimin nr.581, datë 24.12.2003 të saj për disa probleme, si pronësia e truallit dhe kthimi i shtëpisë së re të pushimit të punëtorëve, ka vendosur në kundërshtim me vendimin kryesor.

- Subjektet e interesuara kanë kërkuar bashkëpronësi me shtetin dhe jo njohje të plotë e kthim të shtëpisë së re të pushimit të punëtorëve. Si rrjedhojë, gjykata, duke vendosur kalimin e gjithë shtëpisë së re të pushimit në pronësi të subjekteve të interesuara (Konomi), ka dalë tej caqeve të

objektit të padisë.

- Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vendosur kthimin e godinës së shtëpisë së re të pushimit subjekteve të interesuara, megjithëse kjo kërkesë nuk ishte pjesë e objektit të padisë së paraqitur në gjykatën e rrethit. Duke u gjykuar shtesa e objektit të padisë drejtpërdrejt në gjykatën e apelit, kërkuessit nuk iu dha mundësia të organizojnë si duhet mbrojtjen dhe të bëjnë ankim për provueshmërinë e kësaj kërkesë.

- Gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile, sepse ka pranuar si shtimin e objektit të padisë (pra, bashkëpronësinë mbi shtëpinë e re të pushimit), ashtu dhe ndryshimin e shkaktit ligjor të padisë (referenca tek ligji nr.8340, datë 6.5.1998 “Për pasuritë e sindikatave”). Për mosmarrëveshjet me sindikatat, subjektet e interesuara duhej të ngrinin padi të re.

Subjektet e interesuara, Konomi, kanë parashtruar:

- Kërkuessi ka shterur mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, sepse problemet e ngritura prej tij kanë të bëjnë në thelb me vendimin kryesor të gjykatës së apelit, ndaj të cilit kërkuessi nuk është ankuar brenda afatit ligjor.

- Gjykatat nuk kanë bërë njëkohësisht ndryshimin si të objektit të padisë, ashtu dhe të shkaktit të saj, sepse ky i fundit ka qenë i njëjtë gjatë gjithë gjykimit: e drejta e njohur me ligj për të realizuar njohjen dhe kthimin e pronës sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

- Mosrespektimi i ligjit, zbatimi i keq i tij dhe shkeljet e ligjit procedural, që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, janë shkaqe që ngrihen dhe shqyrtohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor dhe jo nga Gjykata Kushtetuese.

- Pretendimet për vlerën e truallit e të godinës së ngritur mbi të dhe për raportin e ekspertëve kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe me vlerësimin e provave. Ato nuk janë elemente të procesit të rregullt ligjor.

* * *

Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.581, datë 24.12.2003, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, duke pranuar ndër të tjera, në pjesën arsyetuese, që sipërfaqet e trojeve prej 2140 m² dhe 2060 m², bashkë me godinat e Shtëpisë së Pushimit të Punëtorëve, t’u kthehen subjekteve të interesuara (Konomi). Në pjesën urdhëruese të vendimit të gjykatës së apelit, detyrimi për kthimin e trojeve dhe të godinave të pushimit është kushtëzuar me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së pronësisë me pronarët e rinj, pra me sindikatat e pavarura, ndërsa në vendimin nr.51, datë 17.3.2004, duke sqaruar dhe plotësuar vendimin e mëparshëm, ka vendosur që kalimi i pronave të mësipërme subjekteve të interesuara të mos kushtëzohet me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pronarëve të vjetër dhe atyre të rinj.

Kërkuessi pretendon se nuk është thirrur në gjykatën e apelit për gjykimin e kërkesës së subjekteve të interesuara për plotësim dhe sqarim vendimi dhe si rrjedhojë gjykimi është bërë në mungesë të tij.

Nga vendimi plotësues nr.51, datë 17.3.2004 i gjykatës së apelit rezultojnë se kërkuessi nuk është përfaqësuar në gjykim. Mosnjoftimi nga gjykata i palëve pjesëmarrëse në proces përbën element të procesit jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Por në rekursin e paraqitur kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë nuk rezultojnë që ky pretendim të jetë ngritur në atë gjykatë.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, kërkuessi mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e ankesës së tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar kushtëzimin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike jo vetëm për rastet kur individit nuk është ankuar kundër një vendimi gjyqësor në instancat e tjera gjyqësore apo administrative, por dhe për rastet kur, ndonëse ka kundërshtuar vendimin gjyqësor në tërësi, nuk ka ngritur pretendimin që parashtron në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas kërkuessit, vendimi plotësues i Gjykatës së Apelit Vlorë ka dalë tej përmbajtjes së vendimit kryesor të lartpërmendur, përse i përket kthimit, subjekteve të interesuara, të trojeve dhe të godinave të shtëpisë së pushimit, përderisa në vendimin kryesor ky kthim është i kushtëzuar me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ta si pronarë të rinj. Po sipas tij, gjykata e apelit ka vendosur kthimin e gjithë godinës së re të pushimit kur është kërkuar vetëm njohja bashkëpronar në të.

Subjektet e interesuara (Konomi) kanë pretenduar se vendimi plotësues ka bërë thjesht sqarimin dhe plotësimin e vendimit kryesor dhe problemet e ngritura nga kërkuuesi kanë të bëjnë në thelb me vendimin kryesor, ndaj të cilit kërkuuesi nuk është ankuar brenda afatit ligjor dhe në Gjykatën e Lartë. Si rrjedhojë, kjo e fundit nuk ka pranuar t'i marrë ato në shqyrtim.

Gjykata Kushtetuese, në çështjen në shqyrtim, nuk konstaton cenim të parimeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjykatat e sistemit gjyqësor kanë në kompetencë të shqyrtojnë e t'u japin përgjigje pretendimeve të palëve duke respektuar parimet dhe normat kushtetuese, si dhe duke interpretuar dhe zbatuar rregullat procedurale. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin plotësues, u ka dhënë përgjigje kërkesave të subjekteve të interesuara (Konomi) pa tejkaluar kompetencat e veta. Kështu, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 313 e 314 të tij) gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Ajo gjithashtu mund të bëjë plotësimin e vendimit nëse ajo nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova.

Gjykata e apelit, në vendimin plotësues, nuk ka dalë tej përmbajtjes së vendimit kryesor që ajo ka plotësuar dhe interpretuar. Duke shqyrtuar pretendimet e kërkuetit, të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, konstatohet se zgjidhja në atë vendim e kërkesave të paraqitura në gjykatën e apelit është kushtëzuar nga arsyetimi i vendimit kryesor të gjykatës së apelit. Kjo e fundit ka bërë plotësimin dhe interpretimin e atij vendimi, duke u bazuar në argumentet e shprehura në të. Kështu, kthimi i trojeve dhe godinave të shtëpisë së pushimit, të ngritura mbi to, bazohet në pjesën arsyetuese të vendimit kryesor, sipas të cilit "... sipërfaqet 2140 m² dhe 2060 m² të trojeve bashkë me godinën e re të Shtëpisë së Pushimit të Punëtorëve t'u kthehen ish-pronarëve", pa e kushtëzuar këtë kthim me zgjidhjen më parë të mosmarrëveshjeve për pronësinë midis këtyre të fundit dhe sindikatave. Zgjidhja e situatës juridike të trojeve e të godinës së re të pushimit ishte pjesë e domosdoshme e gjykimit dhe e thelbit të mosmarrëveshjes në gjykim dhe gjykata e apelit, duke u nisur nga përmbajtja dhe qëllimi i vendimit kryesor i shprehur në pjesën arsyetuese, sqaroi dhe plotësoi me vendimin plotësues përmbajtjen e pjesës urdhëruese të atij vendimi. Ky korigjim është shprehje e bindjes së gjykatës dhe është ushtruar duke respektuar parimin e gjykatës kompetente. Si rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit se vendimi plotësues i gjykatës së apelit, me këtë kalim pronësie ka dalë tej përmbajtjes së vendimit kryesor, nuk është i bazuar.

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar jurisprudencës së saj kushtetuese¹ dhe asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pranon se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e individit mund të realizohet vetëm kur e ushtron atë brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Por, në çështjen në shqyrtim, kërkuuesi, ashtu siç e pranon dhe vetë, është ankuar brenda afatit procedural vetëm ndaj vendimit plotësues të gjykatës së apelit. E drejta e aksesit në gjykatë, ashtu si dhe e drejta e ankimit, si të drejta themelore u nënshtrohen kufizimeve të cilat, në thelb, nuk përbëjnë cenim të këtyre të drejtave. Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ka parashikuar afate për ushtrimin e tyre. Ky kufizim nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike. Prandaj, Gjykata e Lartë, me të drejtë, nuk ka pranuar të shqyrtojë pretendimet e bëra kundër vendimit kryesor të gjykatës së apelit, si të paraqitur jashtë afatit njëmuor të ankimit. Ajo është përqendruar vetëm te pretendimet e paraqitura kundër vendimit plotësues të asaj gjykate.

- Kërkuuesi pretendon gjithashtu se kërkesa e subjekteve të interesuara për plotësimin e vendimit kryesor të gjykatës së apelit është paraqitur jashtë afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 313 të Kodit të Procedurës Civile dhe, si gjykata e apelit, ashtu dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të tij që kjo kërkesë nuk duhet të merrej në shqyrtim nga gjykata e apelit përderisa është paraqitur tej këtij afati.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimi i kërkuetit ka të bëjë me afatin e paraqitjes së kërkesës për plotësimin e vendimit kryesor, që ka zgjidhur problemet thelbësore të çështjes dhe ky pretendim nuk mund të vlerësohet i një rëndësie të tillë sa të bëjë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

- Kërkuuesi ka pretenduar gjithashtu se gjykata e apelit ka zhvilluar proces jo të rregullt ligjor, sepse në të njëjtin proces ka shtuar objektin e padisë dhe ka ndryshuar shkakun ligjor të saj, veprim i

¹ Vendimet nr.19, datë 23.12.2004 dhe 25, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

cili vjen në kundërshtim edhe me nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtij neni, gjykata, në të njëjtin proces, nuk mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë si objektin e padisë, ashtu dhe shkakun ligjor të saj.

Subjektet e interesuara (Konomi) pretendojnë se gjykata e apelit nuk ka ndryshuar shkakun e padisë, por vetëm ka shtuar, saktësuar dhe plotësuar objektin e padisë, veprime që nuk vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese nuk konstaton cenim të së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit dhe për këtë pretendim. Subjektet e interesuara, gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, kanë bërë kërkesë vetëm për ndryshimin e objektit të padisë, duke e shtuar atë dhe me kërkimin për t'u njohur bashkëpronarë mbi godinën e Shtëpisë së re të Pushimit të Punëtorëve, por nuk kanë ndryshuar shkakun e padisë, pra faktin juridik se ata janë trashëgimtarë ligjorë të ish-pronarit të truallit dhe bazën ligjore ku bazohet kërkitimi i tyre. Mbi bazën e këtyre kërkesave palët kanë bërë pretendimet dhe kanë paraqitur provat, duke pasur mundësi të barabarta për të organizuar mbrojtjen e tyre. Në këtë mënyrë, qëndrimi i gjykatës së apelit është në përputhje me Kodin e Procedurës Civile dhe nuk ka prekur të drejtën themelore të kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

- Përsa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit lidhur me vlerësimet e ekspertëve, Gjykata Kushtetuese thekson dhe një herë se këto pretendime nuk kanë të bëjnë me cenimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor, por me themelin e çështjes dhe me kompetencat e gjykatave të sistemit gjyqësor për të çmuar provat. Konstatimi dhe vlerësimi i fakteve dhe interpretimi i ligjeve apo zbatimi tyre janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor dhe nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese. Kjo e fundit e sheh kompetencën e saj në përcaktimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar në mënyrë të rregullt të drejtat e palëve në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjë vlerësim të provave dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.85, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin i kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kristofor Peçi, Sokol Berberi.

Anëtar kundër: Kujtim Puto.

MENDIM PAKICE

Jam i mendimit se Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Kërkuesi, Sindikata e Pavarur e Transportit, pretendoi ndër të tjera se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e saj plotësues nr.51, datë 17.3.2004 i ka kaluar ish-pronarit (trashëgimtarëve Konomi) pronësinë e trojeve prej 2060 m² e 2140 m² si dhe të ish-shtëpive të pushimit të punëtorëve të ngritura mbi to, në kundërshtim me vendimin kryesor të asaj gjykate nr.581, datë 24.12.2003 që nuk kalonte pronësinë, por ia linte një gjykim tjetër zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë midis subjekteve të interesuara (Konomi) dhe kërkuesit, Sindikatës së Pavarur të Transportit.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, shumica e gjyqtarëve ka pranuar konkluzionin e Gjykatës së Lartë, sipas të cilit vendimi plotësues nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se ka sqaruar përmbajtjen e vendimit kryesor për mënyrën e zgjidhje s së çështjes.

Në kundërshtim me sa ka vendosur shumica, jam i mendimit se gjykata e apelit, në vendimin plotësues, nuk ka bërë thjesht sqarim dhe plotësim të vendimit kryesor, por zgjidhje të ndryshme të problemeve nga sa i ka bërë në vendimin kryesor. Ky qëndrim ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit sepse:

- Në pjesën urdhëruese të vendimit kryesor të gjykatës së apelit, kërkuesi (Sindikata e Pavarur e Transportit) nuk është urdhëruar t'iu kalojë subjekteve të interesuara (Konomi) pronësinë e trojeve dhe godinave të shtëpive të pushimit. Gjykata e apelit, në vendimin e saj kryesor, ka pranuar se pronar është kërkuesi, ndërsa ish-pronar trashëgimlënësit Konomi. Ajo gjithashtu arriti në përfundimin që, para se të vendoset kalimi i pronësisë tek ish-pronarët duhet të zgjidheshin disa probleme që lidheshin me kalimin e pronësisë nga shteti tek sindikatat, si dhe probleme që kishin të bënin me raportin midis ish-pronarit të tokës dhe shtetit, përse i përket ndërtimeve të reja, shtesave e ndryshimeve. Duke u nisur nga këto, gjykata e apelit ka pranuar se ekziston mosmarrëveshje midis subjekteve të interesuara (Konomi) dhe kërkuesit. Sipas vendimit kryesor të gjykatës së apelit dhe praktikës gjyqësore, kjo mosmarrëveshje duhet të zgjidhej në gjykim të veçantë, pas dhënies prej saj të vendimit me objekt anulimi i vendimit të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave. Ky qëndrim është shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit të gjykatës së apelit, sipas të cilit sipërfaqet mbi të cilat ndodhen godinat e shtëpive të pushimit "... t'u kthehen paditësve Konomi pasi të zgjidhen konfliktet për pronësinë e tyre midis ish-pronarëve (paditësve) dhe pronarëve të rinj. Konfederatës së Sindikatave dhe Sindikatave të Pavarura të Transporteve".

Shumica, në vendimin e saj, i referohet një fraze të paqartë të pjesës arsyetuese të vendimit, por nuk përmend që po në këtë pjesë gjykata e apelit shprehet se: "Gjithashtu do të rrëzohet padia dhe përse i përket të drejtës së parablerjes mbi objektet e Kampit të ri dhe të vjetër, pasi në rrethanat e krijuara ajo nuk mund të realizohet sot". Është e qartë se rrethanat e krijuara kishin të bënin me faktin që pronar i tyre në Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme figuronte kërkuesi. Në të kundërt, me qëndrimin e mësipërm, gjykata e apelit, në vendimin plotësues, ka vendosur kalimin e pronësisë së parcelave dhe godinave të ngritura mbi to pa e kushtëzuar këtë kalim pronësie me zgjidhjen më parë të problemit të pronësisë midis pronarëve të vjetër e të rinj. Si rrjedhojë, ajo ka dalë tej caqeve të interpretimit apo plotësimit të vendimit kryesor. Veprime të tilla vinë në kundërshtim dhe me dispozitat e nenit 312 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit pas dhënies së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në llogari, ta plotësojë atë ose të bëjë sqarim apo interpretim të tij, por nuk mund të zgjidhë çështjen në kundërshtim me zgjidhjen që ka bërë me vendimin kryesor. Duke vepruar si më sipër, ajo ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor që ka cenuar të drejtën e pronësisë së kërkuesit, pa i dhënë këtij mundësinë të zhvillojë mbrojtjen në gjykim me objekt të veçantë.

Gjykata e apelit cenoj parimin e sigurisë juridike dhe të mbrojtjes, sepse pranoi për shqyrtim kërkesën për plotësim vendimi, të paraqitur nga subjektet e interesuara, megjithëse ajo ishte paraqitur jashtë afatit njëmuor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile. Për më tepër, gjykimi për marrjen e vendimit plotësues është bërë në mungesë të kërkuesit. Ky i fundit nuk ishte i detyruar të parashikonte se do të pranohej një kërkesë e bërë jashtë afatit ligjor dhe për më tepër që gjykata, në vendimin plotësues, do t'i zgjidhte problemet thelbësore të çështjes në kundërshtim me zgjidhjen që kishte bërë në vendimin kryesor.

- Rezulton gjithashtu se padia e subjekteve të interesuara, e paraqitur në gjykatën e rrethit, ka pasur për objekt kthimin e trojeve, por jo të godinave të shtëpive të pushimit. Kur çështja u kthye nga Gjykata e Lartë për rigjykim në gjykatën e apelit, subjektet e interesuara kërkuan dhe njohjen bashkëpronar me shtetin të godinës së shtëpisë së re të pushimit. Gjykata e apelit pranoi shtesën e objektit të padisë për njohjen bashkëpronar në shtëpinë e re të pushimit dhe caktoi ekspert për vlerësimin e punimeve të bëra nga shteti, vlerësim nga i cili, sipas përqindjes, do të përcaktohej dhe pronësia e palëve mbi godinat dhe truallin. Pranimi i shtesës së objektit të padisë në gjykimin në apel dhe jo në gjykatën e rrethit, siç e përcaktonte Kodi i Procedurës Civile cenoj të drejtën e ankimit të kërkuesit, sepse akti i ekspertimit, megjithëse ishte prova thelbësore ku u bazua gjykata e apelit dhe megjithëse u kundërshtua nga kërkuesi, nuk mund të vihej në diskutim në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, në zbatim të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka kompetencë të verifikojë zbatimin e interpretimin e ligjit, por jo të vlerësojë provat. Është e vërtetë që akti i ekspertimit është një provë dhe Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të shqyrtojë përmbajtjen dhe vlerësimin e provave që kanë bërë gjykatat e sistemit gjyqësor, por nëse do të zbatoheshin rregullat e Kodit të Procedurës Civile. dhe

shtesa e objektit të padisë të pranohej në gjykatën e shkallës së parë dhe jo në apel, ankuesi do të kishte mundësi që kundërshtimet e tij për pranimin nga gjykata të ekspertëve e të aktit të ekspertimit t'i paraqiste e të shqyrtoheshin në një gjykatë më të lartë siç është apeli.

- Gjykata e apelit ka dalë dhe tej kërkesave të parashtruara në objektin e padisë, pasi subjektet e interesuara kanë kërkuar që të jenë bashkëpronarë me shtetin në godinën e re të pushimit dhe jo pronarë të vetëm të saj. *Tejkalimi i caqeve të objektit të padisë përbën cenim të parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor*, gjë që është pranuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në vendimin nr.8, datë 23.4.2004 kjo gjykatë është shprehur se: “Një formë tjetër e shkeljes së të drejtës themelore për proces të rregullt ligjor është dhe ajo e mosrespektimit nga ana e gjykatave të parimit të disponibilitetit të padisë... ato kanë ndryshuar kryesisht dhe pa pëlqimin e kërkuar bazën juridike të padisë, duke e gjykuar atë jo si padi rivendikimi ..., por si padi që rrjedh nga detyrimet e lindura nga kontrata e qirasë së banesave. Pra, në këtë rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kaluar kufijtë e padisë, sepse ajo është shprehur dhe për gjëra që nuk i janë kërkuar, siç është vërtetimi nga ana e saj i ekzistencës së marrëdhënies juridike të qirasë së banesave midis pjesëmarrësve në proces, ose i detyrimit të subjekteve të interesuara t'u paguajnë kërkuarve çmim të reduktuar të qirasë së banesave dhe jo shpërblim për përdorimin e sendit”.

Anëtar: Kujtim Puto

VENDIM
Nr.27, datë 15.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 2.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti, që i përket:

KËRKUES: Mirjana Bekteshi, në mungesë.

Subjekte të interesuara: Ismet Bashli, në mungesë.

Artan Bashli, përfaqësuar nga av.Artan Hajdari, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.4859, datë 22.7.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.767, datë 21.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2007-1022 (1019), datë 7.9.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nenet 189, 190, 161, 31, 32 dhe 18 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE

VËREN:

Kërkuarja Mirjana Bekteshi ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me një kërkesë për shfuqizimin e vendimeve e mësipërme gjyqësore si të papajtueshme me Kushtetutën. Mbledhja e

gjyqtarëve vendosi kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare, datë 28.11.2008. Në këtë seancë kërkesja nuk u paraqit dhe Gjykata Kushtetuese vendosi të procedonte me njoftimin me shpallje në ambientet e saj dhe shtyrjen e seancën plenare më datë 2.12.2008. Edhe në këtë seancë plenare nuk është paraqitur as kërkesja, dhe as përfaqësuesi i saj ligjor, si dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë apo njoftim për shtyrje të seancës apo arsyet e mosparaqitjes së tyre.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile, neni 179, i cili parashikon se “Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten si në veprimet përgatitore, ashtu dhe seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes.”

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, pala kërkuuese është njoftuar për ditën e gjykimit në këtë Gjykatë, sipas procedurës që parashikon neni 38 pika 3 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kështu, meqë kërkesja është më vendqëndrim jashtë shtetit, Gjykata Kushtetuese ka proceduar me njoftimin e saj me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, në seancë rezultoi se kërkesja nuk ka njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitje.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se, përderisa njoftimi me shpallje prezumon dijeninë e kërkueses dhe përderisa kjo e fundit nuk është paraqitur në gjyq, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Kujtim Puto

VENDIM

Nr.28, datë16.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 26.6.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dher të hapura çëshjen nr.11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Viktor Nando, përfaqësuar nga avokat Sokol Puto, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia e qytetit Korçë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.1096, datë 31.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.180, datë 29.9.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr.1412, datë 26.12.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës, neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 27, 28, 30 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkonte rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuari Viktor Nando ka pasur në pronësi një banesë në qytetin e Korçës, e cila është blerë nga babai i tij në vitin 1979 me kontratë të lidhur sipas legjislacionit të kohës. Kjo banesë është regjistruar në hipotekë.

Me vendimin nr.529, datë 28.10.1994, Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave, Korçë, bazuar në nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, e kalon të drejtën e pronësisë së banesës së përmendur më sipër, nga kërkuari te ish-pronari i saj. Kërkuari, sipas këtij vendimi, përfiton masën e shpërblimit me vlef të 308.000 lekë, në formë kompensimi.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.12, datë 21.3.2000 ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “Rregulli për masën e shpërblimit, sipas nenit 10 paragrafi i I-rë (çmimi në kohën e blerjes i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, kur ky indeksim do të llogaritet sipas nenit 27 të ligjit në momentin e hyrjes në fuqi të tij), vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe, pikërisht për këtë shkak, kjo pjesë e nenit 10 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese. Aq sa është e drejtë dhe kushtetuese kthimi i pronave ish-pronarëve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut, d.m.th. vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari”.

Në vitin 2005, kërkuari bën padi kundër bashkisë Korçë, me objekt: Detyrimin e bashkisë Korçë për të paguar vlerën e plotë reale të banesës që i ka marrë kërkuarit në favor të palëve të treta, pagimin e shpenzimeve të kryera në këtë banesë, mbajtjen e banesës deri në momentin e pagimit të plotë të detyrimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1096, datë 31.5.2005, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuari. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.180, datë 29.9.2005, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1412, datë 26.12.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë shkaqesh, sipas parashikimeve të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuari pretendon se vendimet e mësipërme të tri gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, duke dhënë këto shkaqe:

- Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin e pushimit, cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Shprehja në vendimin e gjykatës se “...padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë” është e pabazuar në ligj. Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave parashikonte se bashkia Korçë ishte autoriteti përgjegjës për pagimin e detyrimit financiar për kompensimin e vlerës së banesës. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e apelit është një konkluzion i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka rrëzuar pretendimin e kërkuarit për kërkimin e shpërblimit real për shkak të heqjes së të drejtës së pronësisë, me arsyetimin se shfuqizimi i nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” është bërë nga Gjykata Kushtetuese në një kohë të mëvonshme nga data e marrjes së vendimit nr.529 të Komisionit dhe, për këtë arsye, nuk ka fuqi prapavepruese. Ky është një interpretim i gabuar i ligjit nga gjykata e faktit.

- Vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, është i padrejtë dhe i ka mohuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar kërkoi rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Pretendimet e kërkuarit janë të pambështetura në ligj dhe në një shkak ligjor pasi në asnjë shkallë të gjykimit nuk janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt ligjor.

- Gjatë gjykimit janë respektuar elementet e procesit të rregullt, si parimi i barazisë së palëve dhe zhvillimi i seancës me dyer të hapura.

- Pavarësisht faktit se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.12 të vitit 2000, ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, dhënia e shpërblimit është bazuar në një dispozitë, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë shpërblimi. Kërkuari nuk mund të përdorë si referencë ligjore një akt, i cili nuk ka fuqi prapavepruese dhe si rrjedhojë, nuk i shtrin efektet në marrëdhëniet juridike të lindura dhe të rregulluara më parë.

II

A. Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë

Kërkuari pretendon se Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin e pushimit, cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Përfundimi në vendimin e gjykatës se “...padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë” është i pabazuar në ligj. Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave parashikonte se bashkia Korçë ishte autoriteti përgjegjës për pagimin e detyrimit financiar për kompensimin e vlerës së banesës. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e apelit është një konkluzion i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit.

Gjykata ripërsërit qëndrimin se mohimi i të drejtës së aksesit, d.m.th. i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 13.3.2008, nr.7, datë 11.3.2008, nr.10, datë 11.5.2006*).

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ i siguron çdokujt të drejtën për të pretenduar të drejtat dhe detyrimet civile para një gjykate ose tribunali. Në këtë kuptim ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të filluar një proces para gjykatave për çështje civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut; ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj (*Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, vendim i 23 qershor 1981; Sporrong dhe Lönnroth, vendim i 23 shtator 1982*).

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.180, datë 29.9.2005, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Në vendimin e saj, gjykata, ndër të tjera, shprehet se “... padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë Korçë, ...”. Me këtë arsyetim, jo të plotë dhe të dykuptimshëm, gjykata e apelit ka vënë në diskutim të drejtën e kërkuarit për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje për themelin e pretendimit të tij dhe ka lënë të nënkuptohet që ai nuk ka një bazë ligjore ku mund ta mbështesë padinë e tij.

Gjykata e vlerëson të lidhur me të drejtën e aksesit parimin e deklaruar nga neni 1 i Kodit të Procedurës Civile (KPC): “Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërtënie ose është i paqartë.”.

Në bazë të këtij parimi, gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston, ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjukata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese.

Gjukata çmon se, në rastin në shqyrtim, Gjukata e Apelit Korçë nuk ka respektuar detyrimet e evidentuara më sipër, që rrjedhin nga parimi i parashikuar në nenin 1 të Kodit të Procedurës Civile dhe nga e drejta e kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës. Ajo është mjaftuar duke u shprehur se padia e kërkesit nuk mund të ngrihet ..., duke i cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë një përgjigje nga gjykata për themelin e pretendimit të tij.

Për sa më sipër, Gjukata arrin në përfundimin se pretendimi për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë nga Gjukata e Apelit Korçë me vendimin e pushimit, është i mbështetur.

Gjukata çmon se vendimi nr.1412, datë 26.12.2006 i Kolegji Civil i Gjukatës së Lartë, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit që kundërshtonte vendimin e mësipërm të Gjukatës së Apelit, për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Korçë përmban një interpretim të gabuar të ligjit.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Korçë përmban një interpretim të gabuar të ligjit. Sipas kërkesit, gjykata e faktit duhej të zbatonte në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimin e Gjukatës Kushtetuese nr.12 të vitit 2000, i cili ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe ka fuqi prapavepruese ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar.

B. Lidhur me interpretimin e ligjit nga gjykatat, Gjukata Kushtetuese (Gjukata) është shprehur edhe më parë se interpretimi i dispozitave ligjore për shkakun juridik dhe objektin e padive që duhen ngritur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe vlerësimi juridik i rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët është në kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kjo Gjukatë nuk vlerëson nëse interpretimi i kuadrit ligjor në fuqi nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, bazuar në nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës (*shih vendimet e Gjukatës Kushtetuese nr.8, datë 13.3.2008; nr.6, datë 15.4.2005; nr.36, datë 19.12.2003*).

Gjukata rithekson se vendimet e Gjukatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimin e Gjukatës Kushtetuese nr.5, datë 7.2.2001*).

Në çështjen në shqyrtim, Gjukata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në vendimin e saj, shprehet se *"...vendimi nr.12, datë 21.3.2000 i Gjukatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar paragrafin e parë të nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve" nuk ka fuqi prapavepruese. Kjo nënkupton faktin se ky vendim, i cili ka fuqi erga omnes nuk i shtrin efektet për marrëdhënie juridike të lindura dhe rregulluara më parë. "Pra, gjykata e faktit nuk ka vënë në diskutim fuqinë detyruese të përgjithshme të vendimit të Gjukatës Kushtetuese."*

Gjukata, bazuar në standardet e evidentuara më sipër, çmon se nuk është në kompetencën e saj të vlerësojë nëse Gjukata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka identifikuar dhe ka interpretuar drejt ligjin e zbatueshëm dhe veprimin e ligjit në kohë në çështjen konkrete, përderisa kjo Gjukatë nuk konstaton cenimin e ndonjë aspekti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Për sa më sipër, Gjukata nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit nga Gjukata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjukata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjukatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"*, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.180, datë 29.9.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.1412, datë 26.12.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.12.2008
Doli nga shtypi më 26.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë